



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 185 Akti

Nr. 207 Vendimi
Tiranë, më 08.11.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko
Alma Faskaj
Firdes Shuli

Kryesuese
Relatore
Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, në datën 6.11.2019, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, (underground), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Artur Kalaja**, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Alma Faskaj, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Artur Kalaja, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit, *ex officio*.

2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.

3. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Artur Kalaja, duke krahasuar “Deklaratën e Pasurisë të Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” me deklaratat e pasurisë në vite dhe dokumentacionin justifikues bankar dhe jo bankar etj, të dorëzuar nga vetë subjekti me të dhënat e kërkuara me anë të korrespondencës pranë institucioneve publike. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja konstaton se për subjektin e rivlerësimit, z. Artur Kalaja:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit me shkresën nr. (***) prot., datë 21.1.2018, ka dërguar raportin nr. (***) prot., datë 30.10.2017 (deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. (***), datë 20.11.2018, të KDZH-së), në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Artur Kalaja.

5. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

6. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 1, datë 3.10.2018, të trupit gjykues nr. 4, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016 për të tria kriteret, bazuar në pikën 1, të nenit 4, të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; si dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesuesi i trupit gjykues komisionere Pamela Qirko. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

7. Në datën 7.11.2018 dhe datën 20.11.2018, subjekti i rivlerësimit u njoftua me përbërjen e trupit gjykues, për të cilën, po në këtë datë deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

8. Në datën 28.6.2019, trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Artur Kalaja, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes.

9. Në datën 8.7.2019, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 – 40 dhe 45 – 47, të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe të paraqesë pretendime/sqarime shtesë, brenda datës 18.7.2019.

10. Në datën 11.7.2019, subjekti i rivlerësimit u njoh me materialet e dosjes dhe më 19.7.2019 dërgoi shpjegimet e tij, mbi rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe paraqiti kërkesë për riçelje të hetimit administrativ.

11. Bazuar në kërkesën e mësipërme, për një proces sa më të plotë dhe të gjithanshëm, sa më objektiv, real dhe në respektim të të drejtës së subjektit të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor, Komisioni me vendimin nr. 3, datë 19.7.2019, vendosi që të riçelë hetimin administrativ

12. Komisioni, me vendimin nr. 4, datë 10.10.2019, vendosi mbylljen e hetimit pas riçeljes së tij dhe më 11.10.2019 e njohu subjektin me të gjithë dokumentacionin e ri të administruar për këtë shkak, duke i lënë afat për prapësime deri më 16.10.2019. Subjekti parashtrori argumentet e tij në datën 16.10.2019 dhe njëkohësisht depozitoi një kërkesë për përjashtimin e relatores së çështjes znj. Alma Faskaj nga procesi i rivlerësimit, duke pretenduar konfliktin e interesit.

13. Trupi gjykues i ngritur me vendimin nr. 45, datë 16.10.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit dhe me vendimin nr. (***) prot., datë 22.10.2019, vendosi mospranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit, z. Artur Kalaja për përjashtimin e relatores Alma Faskaj nga procesi i rivlerësimit. Ky vendim iu njoftua subjektit në datën 23.10.2019.

14. Në datën 23.10.2019, trupi gjykues, me vendimin nr. 5, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Artur Kalaja, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016 dhe, me anë të postës elektronike, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 6.11.2019, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë. Komisioni, në të njëjtën datë, njoftoi subjektin për të dhënë shpjegime shtesë (nëse do të kishte), deri në datën 30.10.2019. Subjekti i dorëzoi shpjegimet në datën 30.10.2019.

15. Në datën 6.11.2019 u zhvillua seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm.

II. SEANCA DËGJIMORE

16. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Artur Kalaja, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin.

17. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, z. Artur Kalaja, shprehu qëndrimin e tij lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

18. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Artur Kalaja, kërkoi konfirmimin në detyrë.

19. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Artur

Kalaja. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 6.11.2019, për të rifilluar në datën 8.11.2019, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Z. Artur Kalaja ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur dhe duke dërguar dokumentacionin dhe shpjegimet përkatëse sipas kërkesës së Komisionit, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

21. Procesi i rivlerësimit,, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21.1 Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

21.2 Sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

21.3 Sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

21.4 Ndërsa, sipas kreut VI, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

21.5 Por, referuar vendimit nr. 2/20171, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklaratën e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, që gjenden në dosjen e këtij subjekti dërguar në Komisioni; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga

subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

23. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u vijua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti dhe ligjshmërisë së burimit dhe të krijimit të saj.

23.1 Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës “Vetting”, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Artur Kalaja.

24. Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

25. Procesi i rivlerësimit për komponentin e pasurisë nga Komisioni është bazuar në: (i) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë “Vetting” të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (ii) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratat vjetore të pasurisë për vitet 2003 – 2016 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (iii) hetimin e pasurive të personave të tjerë të lidhur; (iv) dokumentacionin e administruar nga hetimi administrativ.

26. Subjekti i rivlerësimit, z. Artur Kalaja, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë “Vetting” (duke përfshirë personat e lidhur), *në datën 24.1.2017*, në bazë të ligjit nr. 84/2016, fakt ky i konfirmuar nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Pra, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30 ditor nga hyrja e tij në fuqi.

Në “Deklaratën e Pasurisë së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë deklaruar këto pasuri dhe likuiditete:

1. Automjet tip “Mercedes Benz 202 (C250)”, prodhim i viti 1996, blerë me kontratë shitjeje nr. (***) , datë 28.9.2004, me targa (***) , me vlerë 500.000 lekë.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën “Vetting”: kursime familjare, konkretisht nga puna si gjyqtar në Elbasan, duke deklaruar pjesë takuese: 100 %.

Faktet nga hetimi administrativ kryesisht¹

Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, ka deklaruar: *“Autoveturë e markës Benz 250, me vlerë 500.000 lekë, krijuar në bazë të kontratës së shitblerjes nr. (***) , datë 28.9.2004”*. Subjekti i rivlerësimit zotëron 100%.

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, me shkresën nr. (***) prot., datë 8.10.2018, ka vënë në dispozicion të Komisionit dokumentacionin i cili provon origjinën, si dhe aktet e kalimit të subjekti i rivlerësimit.

¹ Shihni shkresën nr. (***) prot., datë 8.10.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor dhe përgjigjen e DPSHTRR-së me shkresën nr. (***) prot., datë 19.10.2018, si dhe materialet shkresore bashkëlidhur.

Nga sa më sipër rezulton e provuar se:

- Me faturën e shitjes nr. 15, datë 14.5.2004, subjekti tregtar “(***)” i ka shitur në vlerën 4.000 euro, blerësit shqiptar B. Q., automjetin e markës “Mercedez Benz C250TD”, prodhim i vitit 1996, ngjyra blu, marshe automatike, shasia nr. (***)

- Sipas deklaratës doganore me referencë (***), datë 16.5.2004 (Dogana Durrës), automjeti është vlerësuar me çmim reference 5.000 euro. Detyrimi doganor për këtë automjet është përcaktuar në shumën 297.838 lekë. Sipas vërtetimit të zhdoganimit nr. (***), datë 16.5.2004, të doganës Durrës konfirmohet shlyerja e detyrimit doganor të automjetit nga importuesi B. Q.. Automjeti regjistrohet pranë Drejtorisë së Shërbimit të Transportit Tiranë dhe pajiset me targa (***) dhe me lejen e qarkullimit nr. (***), datë 10.6.2004.

- Me kontratën e shitblerjejes nr. (***), datë 23.6.2004, shtetasi B. Q. e shet automjetin te blerësi S. P., kundrejt shumës 500.000 lekë.

- Me kontratën e shitblerjejes nr. (***), datë 28.9.2004, shtetasi S. P. e shet automjetin te blerësi Artur Kalaja, kundrejt shumës 500.000 lekë. Në kontratë palët deklarojnë se çmimi i shitjes është likuiduar. Pas nënshkrimit të kësaj kontrate, subjekti e paraqet automjetin për kontroll fizik në DRSHTRR-ja Tiranë, e cila e pajisë me certifikatë të kontrollit fizik nr.(***), datë 8.10.2004 dhe me lejen e qarkullimi të datës 15.10.2004.

Gjatë hetimit administrativ Komisioni ngriti dyshime lidhur me aktet e kalimit të pronësisë për këtë automjet, si dhe çmimin e deklaruar në këto akte.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, i pyetur lidhur me faktet e konstatuara më sipër, në përgjigje të pyetësorit të dytë lidhur me këtë automjet, mbi rrethanat e blerjes së automjetit, marrëdhënien e tij me shitësin, si dhe lidhur me mënyrën e likuidimit të çmimit, pasi deklaroi se njohja me shitësin ka qenë rastësore, bazuar vetëm në interesin e blerjes së automjetit, ka deklaruar ndër të tjera se²:

“Likuidimi i pagesës së mjetit është bërë cash. Mjeti është akoma në zotërimin tim dhe faktet e mësipërme janë të verifikueshme. Megjithëse unë nuk bëj pjesë në personat që kanë njohuri për makinat, vlerësoj se ky mjet nuk është blerë lirë prej meje, rezulton se në të njëjtën vlerë është blerë dhe nga personi që ma ka shitur. Mjeti është blerë me kursimet që familja kishte.”

Në përfundim të hetimit, pasi u hetua mbi rrethanat e konfliktit të interesit mes subjektit të rivlerësimit dhe shtetasve në zinxhirin e akteve të kalimit të pronësisë së automjetit, ku nuk rezultuan prova apo *indicie* mbi këtë rrethanë, Komisioni, çmon se nuk rezultoi e provuar se në rastin konkret jemi para akteve noteriale fiktive me qëllim fshehjen e natyrës së vërtetë të marrëdhënies mes subjektit dhe shitësve, për krijimin e kësaj pasurie si dhe vlerën e vërtetë të saj.

Për sa më sipër, Komisioni çmon se deklarimi i subjektit lidhur me këtë pasuri është i saktë.

Lidhur me analizën e burimit të ligjshëm

Komisioni, në vlerësim të analizës financiare, konstatoi se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, subjekti deklaroi një depozitë bankare dyemërore (subjekti dhe bashkëshortja), në vlerën 256.448 lekë në Bankën e Kursimeve Tiranë që prej vitit 1999, me burim kursime nga të ardhurat. Gjithashtu, po në këtë deklaratë, subjekti deklaroi një depozitë bankare dyemërore në vlerën prej 1.500.000 lekësh në Bankën e Kursimeve Tiranë, me burim vendim nr. (***), datë 25.2.2003, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

² Subjekti i rivlerësimit i ka bashkangjitur pyetësorit kontratën nr. (***), datë 28.9.2004, me shtetasin S.P. .

Komisioni analizoi parashtrimet e subjektit dhe dokumentacionin të vënë në dispozicion prej tij, nga të cilat, në mungesë të të dhënave bankare për atë periudhë, rezultojnë e provuar se:

- Depozita nr. (***), është çelur në datën 9.1.1999 dhe në datën 31.12.2002. Kjo depozitë rezultojnë në shumën 248.451 lekë.

- Drejtorja e Përgjithshme e “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. (***), datë 4.4.2019, konfirmon se në datën 31.12.2003, depozita nr. (***), ka pasur një shumë prej 1.804.644 lekësh, që pasqyrojnë vlerën e depozitës nga viti 1999, shtuar në vitin 2003, shuma prej 1.500.000 lekësh, sipas deklaratës të bërë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003.

- Kjo depozitë rezultojnë se është mbyllur në datën 1.12.2006, fakt që përputhet edhe me deklaratimin, ndërkohë që po atë ditë është çelur si depozitë në “ProCredit Bank”, ku dhe vijon të jetë.

Në vijim, tabela ku pasqyrohet analiza financiare e subjektit të rivlerësimit në vitin 2004.

	Përshkrimi	Viti 2004
1	Pasuri	412,079
	Autoveturë e tip "Mercedes Benz", blerë në vitin 2004	500,000
	Ndryshimi i likuiditetit (shtesa / pakësime)	- 87,921
2	Të ardhura	1,222,421
	Të ardhura nga paga subjekti të dokumentuara	795,926
	Të ardhura nga bashkëshortja të dokumentuara	415,216
	Të ardhura nga interesi i depozitave	11,279
3	Shpenzime	375,456
	Shpenzime jetese ³	375,456
	Diferenca (të ardhura -pasuri-shpenzime 2-1-3)	434,886

Për sa më sipër, nga analiza e dokumentacionit të administruar në dosje, nga deklaratimet e dhëna dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni arrin në konkluzionin se:

- ✓ Subjekti ka deklaruar saktë pasurinë në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe në deklaratën periodike të vitit 200
- ✓ Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e kryera dhe për të justifikuar blerjen e makinës përgjatë vitit 2004, duke rezultuar vetëm për këtë vit me një bilanc pozitiv në vlerë 434.886 lekë.

2. Automjet tip “Mercedes Benz 280 E”, prodhim i vitit 2006, me targa (*), blerë në qershor 2010, me vlerë 14.000 euro.**

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim të krijimit të kësaj pasurie: kursime familjare, nga paga në Gjykatën e Apelit Tiranë, nga viti 2006. Pjesa takuese: 100%.

Faktet nga hetimi administrativ kryesisht⁴

Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, ka deklaruar : “Shtuar pasuria: blerë në datën 17.6.2010 automjet tip Benc 280E (***), me

³ Shpenzime jetese nga ILDKPIKI sipas INSTAT bazuar në përbërjen familjare të subjektit të rivlerësimit

⁴ Shihni shkresën nr. (***), prot., datë 8.10.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor dhe përgjigjen e saj me shkresën nr. (***), prot., datë 19.10.2018, si dhe materialet shkresore bashkëlidhur.

vlerë 14.000 euro. Të ardhurat nga paga e kursime familjare dhe një pjesë nga prindërit; subjekti i rivlerësimit zotëron: 100%”.

Bashkëlidhur shkresës së DPSHTRr-së është dokumentacioni i origjinës së këtij automjeti deri në momentin aktual. Sipas këtij dokumentacioni konstatohet se: Me kontratën e shitjes së automjetit të përdorur të datës 17.6.2010 (gjermanisht), shitësi subjekt tregtar gjerman AK (***) (sh.p.k.) i shet blerësit Artur Kalaja automjetin tip “Daimler Chrysler tip E 280 CDI”, viti i prodhimit 2006, ngjyra e zezë, shasia nr. (***). Çmimi i shitjes **14.000 euro**.

Sipas deklaratës doganore Durrës, me referencë (***), datë 23.6.2010, për këtë automjet janë caktuar detyrime në shumën 603.784 lekë, nga e cila shuma prej 424.427 lekësh është TVSH. Detyrimi në këtë shumë rezulton të jetë paguar bazuar në urdhër çlirim të datës 23.6.2010, të doganës Durrës. Automjeti paraqitet për kontroll fizik në DRSHTRr-në Tiranë, e cila e pajisë automjetin me targën (***) dhe lëshon certifikatë pronësie (***), seria (***), pas verifikimeve të kryera në datën 28.9.2010.

Në lidhje me këtë pasuri, konstatohen disa mospërputhje mes të dhënave në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010 me deklaratën “Vetting”, krahasuar me dokumentacionin e DRSHTRr-së Tiranë, në lidhje me gjetjet, si më poshtë:

Burimi i të ardhurave: në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010 subjekti i rivlerësimit deklaroi se burimi i të ardhurave janë kursimet familjare dhe një pjesë nga prindërit (në këtë deklaratë subjekti i rivlerësimit nuk evidenton shumën që i kanë dhënë prindërit dhe me çfarë titulli ia kanë dhënë: dhurim/hua); në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit deklaroi se burimi i të ardhurave për këtë pasuri janë kursimet familjare nga paga në Gjykatën e Apelit Tiranë, që nga viti 2006 (duke mos evidentuar ndonjë burim tjetër nga prindërit).

Vlera e automjetit: subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vetëm çmimin e kontratës së shitblerjes në Gjermani, pra: 14.000 euro (ose 1.921.640 lekë, sipas kursit të këmbimit të doganës Durrës 1 euro = 137,26 lekë), pa detyrimet e importit në shumën 603.784 lekë.

Nënshkrimi i blerësit në kontratën e shitjes së automjetit me shoqërinë tregtare gjermane AK (***) (sh.p.k.): në kontratë konstatohet se nuk është nënshkrimi i subjektit të rivlerësimit, pra, kontratën e ka nënshkruar dikush tjetër dhe nuk evidentohet nëse pagesa është bërë *cash* apo me bankë. Në përgjigje të kësaj çështjeje subjekti deklaroi se: “*Besoj se dokumentet e blerjes së mjetit janë bërë nga ky shtetas⁵ në emrin tim që në Gjermani, me qëllim për të eliminuar shpenzimet e nevojshme për të bërë kalimin e pronësisë këtu*”.

Pronari i mjetit në lejen e qarkullimit gjermane Nr. (***), të automjetit me targa (***) (shasia e njëjtë si më sipër): kjo leje qarkullimi nuk është lëshuar në emër të subjektit të rivlerësimit, por në emër të shtetasit V. Xh. (me banim në Durrës), në datën 17.6.2010, i cili e ka marrë këtë automjet nga shoqëria tregtare gjermane “(***)”, pra, jo nga shitësi në kontratën e datës 17.6.2010 (AK (***)). Referuar këtij dokumentacioni rezulton se veprimet në lidhje me këtë automjet (blerjen dhe transportimin në Shqipëri) nuk i ka kryer vetë subjekti i rivlerësimit, por shtetasi V. Xh. .

Data në certifikatën e kontrollit fizik nr. (***), datë 24.5.2010: sipas këtij dokumenti vërtetohet se në këtë datë (më 24.5.2010) subjekti i rivlerësimit ka paraqitur për kontroll fizik automjetin në fjalë – por në këtë datë automjeti ende nuk ishte blerë në Gjermani – kontrata e shitjes për këtë automjet është nënshkruar rreth një muaj më pas, në datën 17.6.2010.

Në vijim të hetimit Komisioni kërkoi nga DRSHTRr-ja Tiranë informacion shoqëruar me dokument mbi shkakun e mospërputhjeve në lidhje me certifikatën e kontrollit fizik, me

⁵ Shtetasi shqiptar V. Xh. .

kontratën e shitjes së mjetit mes shitësit “AK (***)” dhe blerësit Artur Kalaja, si dhe me të dhënat në lejen e qarkullimit gjermane Nr. (***) të automjetit me targa (***). Nga përgjigja e këtij institucioni, blerja e një automjeti nga një i tretë (që zakonisht është tregtar automjetesh të përdorura) që nënshkruan kontratën e shitblerjes direkt në emër të klientit, përbën një praktikë të hasur shpesh. Ndërsa në lidhje me mospërputhjen e datës së kontrollit fizik me atë të kontratës së shitblerjes, DRSHTRR-ja Tiranë informoi se ky fakt përbën një gabim material në shkrim, pasi mjete është kontrolluar në qershor të atij viti.

Po kështu, Komisioni i kërkoi Degës Doganore Durrës (Port) informacion dhe dokumentacion mbi personin që ka kryer procedurat doganore të artikullit të deklaratës doganore Durrës me referencë (***), datë 23.6.2010, identitetin e pagesit, mënyrën e pagesës, shoqëruar me dokumentin përkatës. Nga përgjigja e këtij institucioni, formalitetet doganore për këtë automjet janë kryer në emër të shtetasit Artur Kalaja, duke e shoqëruar përgjigjen me dokumentacionin dhe pasaportën e subjektit të rivlerësimit, në të cilin u konstatua se nënshkrimi në mandatpagesë nuk i përkiste këtij të fundit.

Subjekti është pyetur dhe i është kërkuar të provojë me dokumentacion ligjor mbi personin që ka paguar detyrimin doganor për këtë automjet.

Në përgjigje të pyetësorit të dytë subjekti, ndër të tjera, ka sqaruar lidhur me këtë automjet se⁶: *“...me shtetasin V. Xh., nuk kam patur dhe as kam asnjë lidhje apo interes. Nuk kam pasur asnjë njohje dhe nuk isha takuar asnjëherë me këtë shtetas, përpara interesimit tim për blerjen e një mjeti.....Në këto kushte, i kam kërkuar të sjellë nga Gjermania, ku ai e ushtronte këtë aktivitet, një mjet “Benz”, tip E 280, pa ditur ti jap asnjë veçori tjetër. I kam kërkuar gjithashtu, që duhet të dinte, se unë mund të paguaja jo më shumë në total se 12.000 Euro.....Shtetasi V. Xh., më ka telefonuar nga Gjermania, duke më thënë se ka gjetur një mjet të cilin e vlerëson të mirë, por që te unë vjen jo për shumën 12.000 euro, por për 14.000 euro.*

...mjetin me targa provizore gjermane, ma kanë sjellë në Tiranë diku në datën 26.6.2010, dhe unë kam bërë vetë regjistrimin e tij në pronësinë time në Drejtorinë e Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë, duke u pajisur me lejen e qarkullimit dhe targat tona. Deklaroj se dogana e këtij mjeti në Degën Doganore Durrës, nuk është paguar nga unë dhe as me të ardhurat e mia...Si përmenda dhe me lart, kisha rënë dakort për ta marrë mjetin në shumën 14.000 Euro, dhe këtë shumë ia kam likuiduar cash shtetasit V. Xh., në Tiranë, kur më është dorëzuar mjeti dhe dokumentet e tij.....Për pagimin e vlerës prej 14.000 euro, kam marrë hua, pa ndonjë akt të shkruar shumën prej 1.500 euro, nga prindërit, shumë të cilën edhe e kam kthyer pjesë-pjesë. Pjesa tjetër është paguar me kursimet që familja kishte, që nënkupton gjendjen ekzistuese nga viti paraardhës 2009, dhe kursimet e vitit 2010, kur kjo pagesë është kryer.”

Në përgjigje të pyetësorit të tretë, subjekti ka deklaruar: *“Mund të deklaroj me përgjegjësi, se dogana e mjetit me targa (***), në Degën Doganore Durrës, nuk është paguar nga unë, dhe as me të ardhurat e mia. Nëse unë vlerësoj se është paguar nga shtetasi V. Xh., kjo vjen për shkakun se është ky shtetas me të cilin kisha rënë dakord për blerjen e mjetit dhe që e ka sjellë këtë mjet nga Gjermania, e askush tjetër nuk ka patur arsye të bëjë këtë pagesë. Po kështu, me deklaratën noteriale nr. (***), datë 27.3.2019, të cilën ia kam vënë në dispozicion, ky shtetas pohon se pagesa doganore e këtij mjeti është bërë prej tij. Edhe në mandatin e BKT-së Durrës, që gjithashtu ju kam dorëzuar, shënohet se vlera e doganës pranë kësaj banke është “Paguara cash nga të tretë”. Ndërkohë, me marrjen e këtij pyetësori, komunikova me shtetasin V. Xh., duke i kërkuar të më saktësojë edhe nëse pagesa është bërë prej tij nëpërmjet ndonjë agjenti doganor, dhe ai më pohoi, se në kujtesën e tij, e ka bërë pagesën ai personalisht. Në këto kushte,*

⁶ Subjekti i rivlerësimit i ka bashkangjitur pyetësorit mandatin e BKT-së Durrës, datë 23.6.2010, dhe deklaratën noteriale nr. (***), datë 27.3.2019, të shtetasit V. Xh. .

*iu drejtova me kërkesë formale Bankës Kombëtare Tregtare, Drejtorisë së Përgjithshme, duke i kërkuar të më vënë në dispozicion të dhënave të sistemit, lidhur me këtë pagesë, duke i bashkëngjitur kërkesës edhe mandatin e lëshuar prej tyre. Me shkresën nr. (***) prot., datë 26.4.2019, të Bankës Kombëtare Tregtare, Drejtorisë së Përgjithshme, konfirmohet se: ‘...është një pagesë e kryer nga të tretë dhe banka nuk disponon informacion mbi personin që është paraqitur dhe ka depozituar shumën... Emri Arur Kalaja është vendosur si referencë e pagesës doganore dhe jo në cilësinë e personit që ka kryer depozitim...’. Vlerësoj se të gjitha faktet si më sipër provojnë se kjo pagesë nuk është bërë nga unë...’*

Në lidhje me dokumentacionin e *rimbursimit* nga shtetasi V. XH., të TVSH-së së çmimit të automjetit, subjekti ka shpjeguar se: *“Lidhur me rimbursimin që shtetasi V. Xh. ka marrë si rezultat i kësaj pagese, ky shtetas më deklaroi, se ka prurë ndër vite dhjetëra apo më shumë makina dhe nuk ka dokumentacion për makinën time të sjellë 9 vjet më parë. Më deklaroi gjithashtu, se rimbursimi është një praktikë e njohur për të gjithë personat që merren me këtë aktivitet, pavarësisht se unë personalisht, për të qenë i vërtetë, dëgjova për të vetëm për shkak të këtij procesi”*.

Pas mbylljes së hetimit administrativ, me kërkesë të subjektit të rivlerësimit, Komisioni riçeli hetimin me qëllim pyetjen si dëshmitar të shtetasit V. Xh. . Në deklarinë tij dhënë përpara Komisionit, u konstatua se mbi këtë automjet kishte marrë vetëm shumën 14.000 euro (çka përputhet me vlerën e kontratës dhe vlerën e deklaruar për këtë pasuri prej subjektit në deklaratën “Vetting” dhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010), si dhe mohoi që të ketë paguar detyrimin doganor të automjetit.

Nga sa më sipër, në përfundim të hetimit (edhe pas riçeljes), nuk rezultoi dokumentacion ligjor mbi pagesën e detyrimit doganor në emër të shtetasit V. Xh., si dhe as për ndonjë *rimbursim* të ndonjë shume nga ky i fundit (e drejtë që, për një rast të tillë, lind pasi automjeti del nga pika e fundit e kalimit kufitar të Bashkimit Evropian), sipas deklarinë të subjektit të rivlerësimit. Por nuk rezultoi që importi i këtij automjeti, sikundër dhe veprimet dhe pagesa e detyrimeve doganore, të jenë bërë nga subjekti i rivlerësimit. Vlen të theksohet se referuar të dhënave nga sistemi *TIMS* në administrim të Policisë së Shtetit, subjekti i rivlerësimit nuk ka hyrje-dalje nga dhe në Republikën e Shqipërisë në periudhën kur janë kryer veprimet për blerjen e automjetit, transportin dhe futjen e tij në territorin doganor të doganës Durrës.

Si në shpjegime gjatë hetimit, ashtu edhe në seancë dëgjimore, subjekti i rivlerësimit i qëndroi deklarinë të bërë në deklaratën “Vetting” se për këtë automjet kishte paguar vetëm shumën 14.000 euro dhe se nuk kishte qenë ai personi i cili kishte paguar edhe detyrimin doganor në shumën 603.784 lekë në “BKT”, shtuar faktin se shuma prej 424.427 lekësh nga vlera e këtij detyrimi, përbën tatim mbi vlerën e shtuar, që është e *rimbursueshme* në Shqipëri apo në shtetin e origjinës (shtetin dalës nga Bashkimi Evropian) për tregtarin e licencuar e cili e ka futur automjetin në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në seancë dëgjimore, subjekti i rivlerësimit mbajti të njëjtin qëndrim sikurse dhe gjatë hetimit, duke u shpreh se: *“I kam dhënë (shtetasit V. XH.) 14.000 euro. Më ka dhënë dhe ca letra. I kam marrë letrat i kam çuar tek Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor. Kam marrë targat dhe lejen e qarkullimit në emrin tim dhe 10 vjet nuk di asnjë gjë më tutje për makinën. Unë kam qenë në rregull me makinën, ai ka qenë në rregull me mua, s’e kam takuar kurrë personin. Për efekt të këtij procesi marr vesh që e gjithë puna është për doganën, me të drejtë”*.

Trupi gjykues, pasi mori në konsideratë deklarinë të subjektit të rivlerësimit, deklarinë të shtetasit V. Xh., si dhe të gjitha provat shkresore në tërësi, nga të cilat rezultoi se deklarinë të kontradiktore të këtij shtetasit nuk krijojnë bindjen se ka shprehur ndonjë situatë të vërtetë apo

reale, ndërkohë që trupi gjykues, bindet nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit mbi pagesën e vetme të shumës 14.000 euro për pasurinë automjet, sikurse më sipër.

Nga sa më sipër, rezulton se:

➔ **Subjekti ka deklaruar saktë pasurinë në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, por ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, lidhur me përshkrimin e burimit të krijimit të kësaj pasurie, fakte të cilat do të çmohen në tërësi me faktet apo gjetjet e tjera të Komisionit në vlerësimin përfundimtar.**

Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie

Në konsideratë të deklarimeve vjetore të gjendjes së likuiditeteve të subjektit të rivlerësimit dhe të familjarëve konstatohet se prej tij nuk deklarohet ndryshim i gjendjes *cash* si në pasurinë e deklaruar një vit më parë, por si gjendje totale e likuiditeteve, përfshirë edhe gjendjen totale *cash* në deklarin vjetor përkatës. Subjekti, në vitin 2009, deklaroi gjendjen *cash* në shumën 800.000 lekë.

Gjithashtu, konstatohet se deklarata e pasurive dhe interesave të vitit 2010 është e paplotë për sa i takon shumës së përfituar nga pagat si gjyqtar dhe nga paga e bashkëshortes si nëpunëse në Bashkinë e Tiranë. Në këtë vit subjekti nuk ka deklaruar shumën që i ka dhënë babai për blerjen e automjetit.

Bazuar në pikën 14, të nenit 3 dhe në pikën 4, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, shtetasi S. K. plotëson kriteret ligjore për t’u kualifikuar si person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, për të cilin ka detyrimin për të provuar gjendjen pasurore të tij dhe për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive për shumën e dhënë subjektit për qëllim blerje automjeti⁷. Ky përfundim ndikon drejt për drejt në justifikimin ose jo të likuidimit me të ardhura nga burime të ligjshme të çmimit të automjetit.

Komisioni i është drejtuar ILDKPKI-së⁸, lidhur me ndonjë verifikim në lidhje me deklaratën e interesave periodike/vjetore të vitit 2010 (e cila konstatohet se është e paplotë, pasi nga subjekti i rivlerësimit nuk janë deklaruar shumat e përfituara nga paga si gjyqtar, nga paga e bashkëshortes si nëpunëse në Bashkinë e Tiranës dhe as shumën që i kanë dhënë prindërit e tij për blerjen e automjetit). Kjo e fundit informon se subjekti i rivlerësimit, z. Artur Kalaja, nuk ka kryer asnjë shkellje të dispozitave të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, pasi në deklaratën periodike vjetore të pasurive dhe interesave privatë të vitit 2010, në seksionin e deklarinimit të të ardhurave ka deklaruar pagën e tij si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë, si dhe pagën e bashkëshortes pranë Bashkisë Tiranë

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitjen e apartamentit në bashkëpronësi të përfituar nga privatizimi, sipas kontratës së shitjes nr. (***), datë 6.2.2010, në shumën **6.200.000 lekë** dhe deklaroi se kjo shumë është depozituar nga prindërit në “Credins Bank”. Pas verifikimit pranë kësaj banke nga Komisioni, u konstatua se subjekti ka deklaruar gabimisht këtë bankë, pasi shuma e përfituar nga kontrata në fjalë është depozituar në “ProCredit Bank”, sikurse edhe vetë subjekti e deklaroi një gjë të tillë:

“Shuma me të cilën është shitur banesa u depozitua në bankë nga blerësi, po atë ditë, para nënshkrimit të kontratës, në Pro Credit Bank”, që ishte pranë zyrës së noteres, në emër të nënës

⁷ Në pikën 3, të nenit D (fjalja e dytë), të ligjit nr. 76/2016 (Aneks Kushtetuta), përcaktohet se: “Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore”.

⁸ Shihni shkresën nr. (***)prot., datë 28.1.2019, si dhe përgjigjen me shkresën nr. (***)prot., datë 4.2.2019, të ILDKPKI-së.

sime P. K. . Unë nuk kam marrë asnjë pjesë nga shuma e mësipërme, dhe për këtë fakt, në deklarinimin periodik e kam deklaruar si pakësim të pasurisë sime.⁹

Nga verifikimi i llogarisë në “ProCredit Bank” të nënës së subjektit të rivlerësimit rezulton se në datën 6.2.2010, ka depozituar në llogarinë e saj në euro, shumën prej 4.500 euro dhe në llogarinë e saj në lekë, po në këtë bankë, shumën prej 5.450.000 lekësh. Me të dyja këto shuma të depozituara në “ProCredit Bank” prej saj janë çelur dy depozita; depozita prej 4.500 eurosh ka qenë aktive dhe prej saj janë përfituar interesa deri në shkurt të vitit 2014, ndërsa depozita në lekë rezulton të jetë aktive deri në maj të vitit 2018, dhe subjekti nuk ka përftuar apo nuk ka përdorur të ardhura nga shitja e apartamentit në fjalë.

Sipas kontratës së shitjes nr. (***) , datë 6.2.2010, rezulton se ky apartament është shitur nga katër shitës S. K. (babai i subjektit), P. K. (nëna e subjektit), D. K. (e motra) dhe subjekti Artur Kalaja, në shumën 3.780.000 lekë¹⁰, shumë e cila deklarohet se është likuiduar jashtë zyrës noteriale dhe është paguar tatimi lidhur me këtë shumë të përfituar nga të ardhurat nga shitja e apartamentit.

Nisur nga ky fakt, si dhe nga fakti se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij nuk kanë deklaruar asnjë banesë tjetër në pronësi apo në përdorim, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të dhëna mbi banesën e prindërve të tij.

Në përgjigje të pyetësorit të dytë, subjekti ndër të tjera ka sqaruar se: *“Prindërit e mi, S. dhe P. K., nga fillimi i vitit 2010, kur u shit banesa në Njësinë(***) , Rr. ‘(***)’, pall. (***) , dhe deri në dhjetor 2010, kur hynë në apartamentin me sip.50 m², blerë nga shitësit Z., E. dhe A. T. (trashëgimtarë të A. T.), kanë banuar kryesisht me motrën time D. K. në banesën e saj.”*

Subjekti ka deklaruar kontratën e shitjes pranë ZVRPP-së Tiranë, e cila ka përllogaritur detyrimin tatimor për transaksionin: çmimi i kontratës së shitjes është: 80 m² x 67.500 lekë/m² (çmim reference) x 70 % (normë amortizimi) = 3.780.000 lekë; çmimi i kontratës së blerjes (privatizim) është 80 m² x 16.644 lekë/m² = 1.333.120 lekë; tatimi i përllogaritur: 3.780.000 – 1.333.120) x 10 % = 244.688 lekë.

Pra, për sa i takon deklarinimin të pasurisë apartament ndodhur në Rr. “(*)”, Tiranë, në vitin 2010, konstatohen dy mospërputhje:**

- në kontratën e shitblerjes ka vetëm një apartament me sip. 80 m², ndërsa në deklarinimin periodik vjetor të vitit 2010, subjekti deklaron shitjen e një apartamenti dhe të shtesës së tij me sip. 50 m².

- në kontratën e shitblerjes çmimi i likuiduar është vetëm 3.780.000 lekë, ndërsa në deklarinimin periodik vjetor të vitit 2010, subjekti deklaron se ka realizuar shitje në shumën 6.200.000 lekë dhe, sa kaq – e pasaktë, pasi arkëtimi i të gjithë çmimit të shitjes, shumës 6.200.000 lekë, vërtetohet përmes dokumenteve bankare. Sikurse thuhet dhe më lart, ditën e kryerjes së veprimit noterial të kalimit të pronësisë së apartamentit dhe shtesës pa leje të tij, çmimi i paguar nga blerësit E. dhe E. R., në shumën 6.200.000 lekë, është depozituar nga nëna e subjektit të rivlerësimit në dy llogari bankare në emër të saj në “ProCredit Bank”.

⁹ Subjekti i rivlerësimit i ka bashkangjitur pyetësorit vërtetimin datë 6.2.2010, të “ProCredit Bank” dhe *statement* i bankës po atë ditë

¹⁰ Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ZVRPP-ja Tiranë rezulton se nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. (***) , datë 6.2.2010, subjekti, prindërit dhe e motra e subjektit kanë shitur një apartament me sip. 80 m² në Rr. “(***)”, të blerësi E. R. (20 vjeç) kundrejt çmimit 3.780.000 lekë, të likuiduara më parë jashtë zyrës noteriale. Të gjithë shitësit në këtë kontratë përfaqësoheshin nga subjekti në bazë të prokurës nr. (***) , datë 4.2.2010, pjesë e dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ZVRPP-ja Tiranë janë edhe dy dokumente: dokumenti pasqyrë llogaritëse e tatimit për kalimin e të drejtës së pronësisë; dhe mandatpagese në sportel të “Credins Bankës” nr. (***) , datë 8.2.2010 sipas të cilit, subjekti paguan shumën 244.680 lekë, tatim

Për të qartësuar origjinën e mospërputhjeve të konstatuara, Komisioni merr në vlerësim informacionin dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion nga organet tatimore (mbi detyrimet tatimore të likuiduara nga subjekti i rivlerësimit, personi i lidhur dhe të afërmit e tyre), si dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t¹¹ në lidhje me aplikime të mundshme për legalizimin e ndonjë ndërtimi pa leje¹².

Nga organet tatimore konfirmohet se vetëm personi i lidhur F. K. ka të dhëna të regjistruara si subjekt tatimpagues në DRT-në Tiranë. Në këtë mënyrë, për shumën 6.200.000 lekë (sipas deklaratës nga subjekti në vitin 2010), apo për diferencën në shumën prej 2.420.000 lekësh (që rezulton pasi zbrisim çmimin e kontratës nga shuma e deklaruar), Komisioni krijoi dyshimin se subjekti dhe personi tjetër i lidhur mund të mos kenë likuiduar detyrime tatimore.

Nga ALUIZNI Tirana – 2, konfirmohet fakti se subjekti dhe babai i tij, z. S. K., kanë depozituar formularin e vetëdeklarimit për legalizimin e shtesës¹³, në Njësinë Bashkiake Nr. (***), Tiranë, sipas të cilit nga aplikuesit deklarohet se në vitin 2003 kanë realizuar një shtesë prej 52 m² në apartamentin e ndodhur në Rr. “(***), nr. (***), Tiranë, shtesë e cila në momentin e shitjes së apartamentit ka qenë e papërfunduar, vetëm si karabina. Nga fotografitë e jashtme të objektit, konstatohet se i gjithë pallati ka një shtesë uniforme, pra, duket se është realizuar nga të gjithë banorët e pallatit. Gjithsesi, nga ALUIZNI Tirana – 2, Komisioni informohet se në dosjen e legalizimit në fjalë është administruar edhe kontrata e shitblerjes¹⁴.

Mbi faktin e shitjes së apartamentit së bashku me shtesën, në shumën 6.200.000 lekë, shumë e likuiduar te prindërit e subjektit të rivlerësimit, konfirmuan edhe shtetasit E. dhe E. R., të thirrur me cilësinë e dëshmitarëve në hetimin administrativ¹⁵.

Komisioni çmon se nga tërësia e provave të administruara gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit, pavarësisht nga fakti se ka qenë bashkëpronar në këtë pasuri, nuk ka përfituar asnjë të ardhur nga shitja dhe për pasojë, mospagimi i detyrimeve tatimore, specifikisht për të ardhurat nga shitja e shtesës së apartamentit në shumën 2.420.000 lekë, nuk e ngarkon subjektin me përgjegjësi, duke shtuar në lidhje me këtë edhe faktin se këto të ardhura nuk janë në asnjë rast burim i ndonjë pasurie apo likuiditeti të subjektit të rivlerësimit.

Në deklaratën periodike vjetore të pasurive dhe interesave në vitin 2010, nga subjekti janë deklaruar të ardhura nga qiraja në shumën 200 euro/muaj, për njësinë e përfituar nga bashkëshortja e subjektit në bazë të kontratës së shkëmbimit që kishte me shoqërinë “(***)” sh.p.k. Marrëdhënia e qirasë provohet me dy kontrata (të vëna në dispozicion nga subjekti gjatë hetimit administrativ): kontrata e datës 30.9.2010 (me qiramarrës subjektin tregtar me NIPT (***), person fizik A. K.) dhe kontrata nr. (***), datë 10.2.2016 (me qiramarrës subjektin tregtar me numër NIPT (***), konkretisht shoqërisë “(***)” sh.p.k.), për një ambient të ndodhur në adresën: Rr. “(***), pallati “(***), nr. (***), shk. (***), k. (*** (i ndërimit), Njësia Bashkiake (sot Njësia Administrative) Nr. (***), Tiranë.

Në kuadër të hetimit administrativ, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit kontratat në fjalë, si dhe mandatpagesat e qirasë së ambientit dhe të detyrimeve fiskale të pasurisë në fjalë.

¹¹ Shihni shkresë nr. (***), prot., datë 8.10.2019, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI dhe përgjigjen me shkresën nr. (***), prot., datë 16.10.2018, si dhe shkresën nr. (***), prot., datë 23.10.2018, si dhe materialet bashkëlidhur.

¹² Shihni shkresë nr. (***), prot., datë 8.10.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe përgjigjen me shkresën nr. (***), prot., datë 12.10.2018, si dhe shkresën nr. (***), prot., datë 30.10.2018 dhe dokumentacionin bashkëlidhur.

¹³ Formulari me nr. (***), prot., datë 17.8.2006.

¹⁴ Shihni kontratën nr. (***), datë 6.2.2010, e cila përmban një vërtetim noterial njehsimi me origjinalin nr. (***), rep., datë 18.8.2014.

¹⁵ Shihni - procesverbal nr. (***), prot., datë 9.9.2019 – deklaratë, datë 29.8.2019, z. E. R. .
- Procesverbal nr. (***), prot., datë 29.8.2019 – deklaratë, datë 29.8.2019, z. E. R. .

Mbi këtë marrëdhënie qiraje, si dhe mbi faktin e likuidimit të detyrimeve tatimore për të ardhurat nga qiraja (mbajtur nga qiramarrësi si tatim në burim), ka konfirmuar edhe Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë¹⁶.

Komisioni kërkoi sqarime nga subjekti i rivlerësimit lidhur me të ardhurat nga qiraja të deklaruar në një formë të paqartë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, të ardhura të cilat nuk janë deklaruar as deklaratën “Vetting” dhe për të cilat ka vënë në dispozicion vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë¹⁷, ku konfirmohen pagesat e kryera për tatimin në burim nga z. A. K., në favor të znj. F. K., për periudhën shtator 2010 – shkurt 2016. Mbi këtë gjetje, si gjatë hetimit¹⁸, ashtu edhe në seancë dëgjimore¹⁹, subjekti është shprehur se në vitin 2010 ka deklaruar marrëdhënien e qirasë, si një e ardhur periodike e pandryshueshme, e cila nuk pësoi ndryshime në asnjë vit në vazhdim. Ndërsa mosdeklarimin e të ardhurave nga kontrata e qirasë në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti e çmoi si pasaktësi në deklaram nga pakujdesia.

Komisioni çmon se bazuar në pikën 3, të nenit D (fjalë e dytë), të ligjit nr. 76/2016 (Aneks Kushtetuta), të ardhurat e realizuara nga kontrata e shitblerjes së apartamentit dhe shtesës nr. (*) , datë 6.2.2010, janë të ligjshme vetëm në shumën 3.780.000 lekë, pasi detyrimet tatimore ndaj shtetit janë shlyer deri në këtë shumë. Për sa i takon diferencës në shumën 2.420.000 lekë, kjo shumë nuk çmohet e ardhur e ligjshme sipas dispozitës Kushtetuese të mësipërme, por Komisioni çmon faktin se subjekti i rivlerësimit nuk rezulton që të ketë përfituar ndonjë pjesë të këtyre shumave.**

Gjithashtu, bazuar në pikën 3, të nenit D (fjalë e dytë), të ligjit nr. 76/2016 (Aneks Kushtetuta), të ardhurat e realizuara nga dy kontratat e qirasë (më 30.9.2010 dhe më 10.2.2016), çmohen të ligjshme. Por, subjekti ka gabuar duke mos e deklaruar krijimin e tyre dhe ndryshimet përkatëse ndër vite dhe po kështu në deklaratën “Vetting”, përveç vitit 2010, fakte të cilat do të çmohen në tërësi me faktet apo gjetjet e tjera të Komisionit në vlerësimin përfundimtar.

Në përfundim, duke vlerësuar si më të rëndësishme përmbajtjen e deklaratës “Vetting”, Komisioni çmon se në krijimin e pasurisë automjet tip “Mercedez Benz 280 E”, prodhim i vitit 2006, me targa (*) , blerë në qershor të vitit 2010, në vlerën 14.000 euro, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë përdorur të ardhura të realizuara nga babai i tij, apo të ardhura me burim nga shitja e apartamentit të ndodhur në Rr. “(***)”, Tiranë.**

Për sa më sipër, Komisioni analizoi nga pikëpamja financiare mundësinë e subjektit të rivlerësimit që me të ardhurat e familjes së tij nga burime të ligjshme, të krijonte shumën prej 14.000 euro, për blerjen e automjetit në fjalë, sikurse në tabelën përmbledhëse, si më poshtë:

Analiza financiare viti 2010

	Përshkrimi	Viti 2010
1	Pasuri	1,731,344

¹⁶ Shihni: 1) Konfirmim për tatim në burim, shkresa nr. (***) prot., datë 2.4.2019, në bazë të të cilit vërtetohet se nga shtetasi A. K. me NIPT (***) , janë derdhur në favor të shtetases F. K., si të ardhura në buxhetin e shtetit për periudhën shtator 2010 – shkurt 2016, si tatim në burim në zërin “*tatim qira*”, në bazë të kontratës së datës 30.9.2010, shuma totale 178.200 lekë.

2) Konfirmim për tatim në burim, shkresa nr. (***) prot., datë 2.4.2019, në bazë të të cilit vërtetohet se nga shtetasi A. K. me NIPT (***) , janë derdhur në favor të shtetases F. K., si të ardhura në buxhetin e shtetit për periudhën shkurt 2016 – dhjetor 2018, si tatim në burim në zërin “*tatim qira*”, në bazë të kontratës nr. (***) , datë 10.2.2016, shuma totale 60.900 lekë.

¹⁷ Shihni vërtetimin nr. (***) prot., datë 2.4.2019 nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.

¹⁸ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

¹⁹ Shihni procesverbalin e seancës dëgjimore, datë 6.11.2019.

	Autoveturë e tip "Benz" 280 (***) ²⁰	1,943,340
	Ndryshimi i likuiditetit (shtesa / pakësime)	- 211,996
2	Të ardhura	2,191,584
	Të ardhura nga paga subjekti të dokumentuara	1,176,684
	Të ardhura nga bashkëshortja të dokumentuara	661,278
	Të ardhura nga qiraja	97,200
	Të ardhura nga interesi i depozitave	256,422
3	Shpenzime	665,857
	Shpenzime jetese ²¹	546,480
	Shpenzime udhëtimi ²²	119,377
	Diferenca (të ardhura -pasuri-shpenzime 2-1-3)	- 205,617

Nga sa më sipër, rezulton se:

- ✓ Subjekti e ka deklaruar saktë pasurinë në deklaratën “Vetting”.
- ✓ Subjekti nuk disponon të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për të blerë në qershor të vitit 2010, pasurinë automjet tip “Mercedez Benz 280 E”, prodhim i vitit 2006, me targa (***), si dhe të përballojë shpenzimet e tjera deri në këtë moment, pasi ka një mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën 205.617 lekë.

3. Depozitë në shumën 9.500 euro, në datën 15.3.2016, në “Credins Bank”, në emër të subjektit

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim të krijimit të kësaj pasurie: **Pjesërisht nga kursimet familjare të vitit 2014, të deklaruar cash dhe pjesërisht nga kursimet e të ardhurave familjare të vitit 2015 nga paga e subjektit, si dhe fitimi i bashkëshortes si notere. Pjesa takuese: zotërimi 100 %.**

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ²³

Mbi depozitën prej 9.500 euro subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015: “*Depozituar në emrin tim në “Credins Bank” shuma prej 9.500 euro. Kjo shumë vjen si kursime të familjes gjatë vitit të kaluar, të deklaruar si gjendje cash, si dhe gjatë këtij viti*”.

Në fund të këtij viti, subjekti i rivlerësimit deklaroi gjendje cash në shumën 500.000 lekë, si dhe interesa bankare të depozitës në emër të tij në “ProCredit Bank” dhe interesat bankare të depozitës në emër të bashkëshortes në “Intesa Sanpaolo Bank”.

Nga informacioni i administruar në dosjen e Komisionit nga “Credins Bank” rezulton se në datën 15.3.2016 është depozituar shuma prej 9,500 euro në llogarinë e subjektit të rivlerësimit me përshkrimin “*Derdhje në llogari nga Artur Kalaja, të ardhura nga kursimet familjare*”.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi: “*Sqaroj se në datën.15.3.2016, unë kam çelur një depozitë pranë ‘Credins Bank’, në shumën 9.500 euro. Si sqarova më lart, me të njëjtin mendim se kjo shumë, vjen nga kursimet e vitit 2015, përfshirë edhe diferencën në cash*”

²⁰ Vlera e automjetit në kontratën e shitjes është 14,000 euro por tek kjo vlerë janë shtuar dhe detyrimet doganore në shumën 603.784 lekë të paguara nga subjekti i rivlerësimit, z. Artur Kalaja, konvertuar në lekë sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2010.

²¹ Shpenzime jetese nga ILDKPIKI-ja sipas INSTAT bazuar në përbërjen familjare të subjektit të rivlerësimit.

²² Shpenzimet e udhëtimit të rezultuara nga sistemi TIMS.

²³ Shkresë nr. (***) prot., datë 8.10.2018, drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë; “Credins Bank” ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 31.1.2018. “ProCredit Bank” ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 11.10.2018; “Intesa Sanpaolo Bank” ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 18.10.2018; “Raiffeisen Bank” ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 12.10.2018; Banka Kombëtare Tregtare ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 24.10.2018.

që nga viti 2014, kam deklaruar gjendjen faktike, duke e cituar si depozitë në deklarin periodik bërë në mars 2016, megjithëse referuar vitin kalendarik, do të duhej ta deklarova si gjendje cash deri në datën 31.12.2015..... Vlerësoj se rastet e mospërputhjeve si më sipër, duke ndryshuar vetëm zërin e të ardhurave të deklaruara nga 'cash' në 'depozitë bankare' për vitin respektiv, nuk kanë sjellë pasaktësi në vlerën e pasurisë së deklaruar, dhe janë bërë me kuptimin dhe qëllimin për të pasqyruar sa më saktë gjendjen reale në momentin e deklaramit. Gjithsesi, kërkoj ndjesë, pasi kuptoj se formalisht, referuar formularit të deklaramit, duhet të ishte ndryshe”.

Nga “Credins Bank” konfirmohet depozita në shumën prej 9.500 euro në emër të subjektit të rivlerësimit e çelur në datën 15.3.2015. Në këtë bankë kanë llogari subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja.

Rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, depozitën prej 9.500 euro në emër të tij në “Credins Bank”, por ka deklaruar në mënyrë të pasaktë në deklaratën periodike vjetore të pasurive të vitit 2015, fakt i cili do të çmohet në tërësi me faktet apo gjetjet e tjera të Komisionit në vlerësimin përfundimtar.

Për sa më sipër, Komisioni analizoi nga pikëpamja financiare mundësinë e subjektit të rivlerësimit që me të ardhurat e familjes së tij nga burime të ligjshme të krijonte shumën prej 9.500 euro, për krijimin e depozitës në fjalë, sikurse në tabelën referuar analizës financiare përmbledhëse (shih: tabelën në vijim).

Nga sa më sipër, rezulton se:

- ✓ **Subjekti ka deklaruar saktë pasurinë depozitë në shumën 9.500 euro në “Credins Bank” në deklaratën “Vetting”.**
- ✓ **Subjekti disponon të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për të krijuar depozitën bankare në vitin 2015.**

4. Gjendje cash në vlerën 600.000 lekë

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim të krijimit të kësaj pasurie: **shumë që vjen nga gjendja e deklaruar dhe e mbetur nga viti i kaluar dhe kursimet familjare të këtij viti.** Pjesa zotëruese: zotërimi 100 %.

Faktet nga hetimi administrativ kryesisht²⁴

Deklarata e pasurisë “Vetting” për vitin 2017 është dorëzuar në datën 27.1.2017. Për pasojë, me shprehjen e deklaruesit “*e mbetur nga viti i kaluar*” do të kuptohet viti i deklaramit periodik 2016 (deklarata për këtë vit depozitohet në ILDKPKI deri në datën 31.3.2017), ndërsa me shprehjen “*kursimet familjare të këtij viti*” do të kuptohet viti 2016.

Në deklaratën periodike të vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

- 1. Depozituar në datën 4.1.2017 në “Intesa Sanpaolo Bank” në emrin e bashkëshortes F. K. shuma prej 7.500 euro. Kjo shumë vjen si kursime të familjes gjatë vitit 2016.*
- 2. Depozitat e deklaruara në vitet përkatëse nuk kanë ndryshime, veç interesave bankare.*
- 3. Gjendje cash, në familje janë 700.000 lekë, që vjen nga gjendja e deklaruar e vitit 2016, si dhe kursimet familjare.*

Gjithashtu, në rubrikën e deklaramit të të ardhurave të këtij viti, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

²⁴ Shihni shkresë nr. (***) prot., datë 8.10.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si dhe përgjigjen e DRT-së Tiranë me shkresën nr. (***) prot., datë 30.10.2018, si dhe informacionin nga sistemi të dhënave c@ts bashkëlidhur.

4. “Llogari rrjedhëse në “BKT”, në datën 4.1.2017, në emër të F. K. – person fizik, që fillon nga viti 2013, në realizim të aktivitetit të përditshëm si noter, ka ndryshuar nga viti paraardhës duke u shtuar vetë, me 6.630 lekë (aktualisht është 540.954,42 lekë)”.

Nga sa më sipër, konstatohet se në këtë deklaratë subjekti i rivlerësimit duket se e tejkalon periudhën e deklaramit, pasi shprehet mbi gjendjen pas vitit 2016. Periudha e deklaramit duhet të përfshijë të gjitha ndryshimet që pësojnë pasuritë që përbëjnë objekt deklarami, sipas nenit 4/a, b, c, ç, d të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive...” (ndryshuar), deri në datën 31 dhjetor të vitit të deklaramit.

➔ **Për pasojë, rezulton se nga subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaratën periodike vjetore 2016, duke mos deklaruar saktë atë vit gjendjen *cash* të kursyer.**

Në analizë të përgjigjes së subjektit lidhur me deklaramet e gjendjeve *cash* dhe llogarive bankare të hapura, pikërisht jo në vitin e deklaramit, konkluzioni i mësipërm nuk ndryshon. Subjekti deklaron gjatë hetimit administrativ dhe në seancë dëgjimore se ka pasur pasaktësi të deklaramet periodike vjetore lidhur me gjendjen *cash* që duhej të deklaronte në fund të çdo viti.

Për sa më sipër, Komisioni analizoi nga pikëpamja financiare mundësinë e subjektit të rivlerësimit që me të ardhurat e familjes së tij nga burime të ligjshme (sipas dokumentacionit të administruar), të krijonte kursime *cash* shumën 600.000 lekë (shihni tabelën analitike të pasurisë nr. 3).

➔ **Sipas analizës financiare për vitin 2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e kryera përgjatë vitit 2016 dhe për të justifikuar shtesën në kursimet e këtij viti.**

Nga sa më sipër, rezulton se:

- ✓ Subjekti ka deklaruar saktë pasurinë gjendje *cash* në shumën 600.000 lekë në deklaratën “Vetting”.
- ✓ Subjekti disponon të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për të krijuar gjendjen *cash* deri në fund të vitit 2016.

DEKLARIMI I BASHKËSHORTES SË SUBJEKTIT – F. K. – PERSON I LIDHUR

5. Apartament 2+1, ndodhur në Rr. “(*)”, Tiranë**

Burimi i krijimit: përfituar me privatizim në bazë të ligjit “Për privatizimin e banesave shtetërore” me kontratën e datës 16.11.1994, me ish-Ndërmarrjen Komunale Banesa nr. (***), Tiranë . Vlera: 1.257 lekë. Pjesa takuese: 20 %.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit²⁵

Nga ZVRPP-ja Tiranë konfirmohet kalimi i pronësisë së apartamentit në bazë të kontratës së shitblerjes nr. (***), datë 16.11.1994, mes palës shitëse Ndërmarrja Komunale Banesa, Nr. (***), Tiranë dhe blerësve: T., K., E., F. (K.) dhe A. H. . Bashkëpronësia mbi këtë apartament ka ndryshuar si pasojë e transaksioneve mes bashkëpronarëve, në bazë të të cilave është rritur vetëm pjesa takuese e z. E. H. . Aktualisht personi i lidhur vazhdon të zotërojë 1/5 pjesë takuese të bashkëpronësisë, ose 20% të saj.

²⁵ Shihni shkresën nr. (***) prot., datë 8.10.2018 drejtuar ZQRPP-së dhe ZVRPP-së Tiranë ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 22.10.2018, si dhe materialet bashkëlidhur.

Nga sa më sipër, rezulton se:

- ✓ Subjekti ka deklaruar saktë pasurinë gjendje *cash* në shumën 600.000 lekë në deklaratën “Vetting”.
- ✓ Deklarimi i personit të lidhur në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 përputhet me dokumentacionin e ZVRPP-së Tiranë.

6. Në zbatim të kontratës së shkëmbimit nr. (***) , datë 5.11.2013, midis znj. F. K. dhe shoqërisë “(***)” sh.p.k. është përfituar nga ndërtimi i kryer në pasurinë nr. 2/84, truall me sip. 800 m², ndodhur në Rr. “(***)”, Tiranë (ku dhe banojnë):

- apartament, me sip. 152.5 m², nr. (***) ;
- njësi, me sip. 20.20 m², nr. (***) ;
- garazh me sip. 31.72 m², nr. (***) .

Pasuria truall me sip. 800 m² dhe banesë 2-katëshe mbi të kthyer me vendim nr. (***) , datë 14.11.2001, të K. K. Pronave Tiranë, nënës së bashkëshortes së subjektit, znj. K. H. (T.), e cila ka lidhur kontratë sipërmarrjeje nr. (***) , datë 2.11.2002, me shoqërinë “(***)” sh.p.k. Nga pjesa e saj në pasurinë truall me sip. 800 m² dhe banesë 2-katëshe, i dhuron me kontratë dhurimi nr. (***) , dt. 22.9.2003, vajzës së saj, bashkëshortes së subjektit 1/3 pjesë. Zotërimi: 100%.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit²⁶

Mbi bashkëpronësinë për truall me sip. 800 m² dhe shtëpi 2-katëshe, në pjesë takuese ideale prej 1/12, të fituar me kontratë dhurimi nga nëna e saj dhe e lënë për ndërtim pallati, personi i lidhur e ka deklaruar që në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003.

Me vendimin nr. (***) , datë 14.11.2011, të ish-KKKP-së, trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar, z. R. T., i kthehet, trualli me sip. 800 m² dhe banesë 2-katëshe, ndodhur në lagjen “(***)”. Një nga trashëgimtarët është vjehrra e subjektit të rivlerësimit, znj. K. H. (T.). Kjo pronë rezulton që të jetë regjistruar në ZVRPP-në Tiranë si pasuria nr. (***) vol. (***) , f. (***) , z. k. (***) , në emër të bashkëpronarëve të familjes T., sipas dëshmimeve të trashëgimive për ish-pronarin (i ndjeri) R. T. .

Me kontratën e sipërmarrjes²⁷ bashkëpronarët T. (ku mes të cilëve bën pjesë edhe znj. K. H.) kanë vendosur që ta vënë truallin me sip. 800 m² në dispozicion të shoqërisë “K.” sh.p.k., për ndërtim të një pallati, në këmbim të sipërfaqeve ndërtimore (apartamente, garazhe dhe dyqane) në përputhje me raportet e përcaktuara sipas kësaj kontrate. Në lidhje me ndërtesën 2-katëshe, palët kanë rënë dakord për shembjen e saj, pas miratimit të lejeve përkatëse (vendim për miratim të sheshit të ndërtimit, leje për ndërtim objekti shumëkatësh, leje për prishje të objektit ekzistues). Kjo kontratë rezulton që të jetë regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, me të cilën është vendosur bllokimi i pronës në favor të shoqërisë së ndërtimit. Sipas nenit 4.1 të kontratës së sipërmarrjes, bashkëpronarët e truallit (së bashku) do të përfitojnë 30 % të sipërfaqes së ndërtimit të realizuar mbi pronën e tyre, por jo më pak se: parkime = 200 m²; dyqane = 300 m² (të ndara: 150 m² në k.1 dhe 150 m² në k. 2); apartamente = 800 m². Në rast se kuotës 30 % të ndërtimit i përket një sipërfaqe më e madhe se sipërfaqet e mësipërme, ato do të plotësohen deri sa të arrihet sipërfaqja përkatëse e raportit 30 %.

Sipas kontratës së dhurimit nr. (***) , datë 22.9.2003²⁸, znj. K. H. i dhuron të bijës, znj F. K. kuotën 1/3 e pjesës prej 1/4 (ose 67 m² truall) nga pasuria truall me sip. 800 m², si dhe po 1/3

²⁶Shihni shkresën nr. (***) prot., datë 8.10.2018, drejtuar ZQRPP-së dhe ZVRPP-së Tiranë ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 22.10.2018, si dhe materialet bashkëlidhur.

²⁷ Shihni kontratën nr. (***) , datë 2.12.2002.

²⁸ Shihni kontratën e dhurimit nr. (***) , datë 22.9.2003.

e 1/4 nga ndërtesa 2-katëshe mbi këtë truall. Në këtë kontratë evidentohet fakti se prona më parë ishte disponuar nga të gjithë bashkëpronarët në favor të shoqërisë “(***)” sh.p.k., për ndërtimin e një pallati, duke ia kaluar pranueses së dhurimit të drejtën e lidhjes së kontratës së shkëmbimit për sipërfaqet ndërtimore takuese. Gjithashtu, në dokumentacionin e pronësisë është vendosur shënimi i bllokimit me barrë hipotekore në favor të shoqërisë “(***)” sh.p.k.²⁹

Bazuar në pikën 14, të nenit 3 dhe në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, shtetasja K. H. plotëson kriteret ligjore për t’u kualifikuar si person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, për të cilin ka detyrimin për të provuar gjendjen pasurore të saj dhe për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së dhuruar. Sikurse evidentohet më sipër, pasuria e dhuruar buron nga trashëgimia ligjore e subjektit të shpronësuar (i ndjeri) R. T., për pronën e të cilit është vendosur me vendim të ish-KKKP-së kthimi i saj fizikisht te trashëgimtarët e tij.

Konstatohet se qëllimi i kontratës së dhurimit është përfshirja drejtpërdrejt e pranueses së dhurimit në marrëdhënien e shkëmbimit si bashkëpronare e pasurisë që zhvillohet me shoqërinë investitore/ndërtuese, fakt që del edhe nga kontrata.

Shoqëria “(***)” sh.p.k.³⁰ bazuar në kontratën e sipërmarrjes³¹ kaloi në pronësi të bashkëpronares F. K. këto pasuri të cilat i përkasin pallatit të ndërtuar në pasurinë e cituar më sipër:

- **apartament** me sipërfaqe **171,75 m²**, nga të cilat 152,5 m² sipërfaqe banimi dhe 19,25 m² sipërfaqe të përbashkëta, regjistruar në ZVRPP-në Tiranë si pasuria nr. (***), vol. (***), f. (***), z.k. (***)
- **njësi (dyqan)** me sipërfaqe **20,2 m²**, regjistruar në ZVRPP-në Tiranë si pasuria nr. (***), vol. (***), f. (***), z. k. (***)
- **garazh** me sipërfaqe **31,72 m²**, regjistruar në ZVRPP-në Tiranë si pasuria nr. (***), vol. (***), f. (***), z. k. (***)

Në kontratë evidentohet se shkëmbyesja F. K. zotëron 1/11 pjesë të pasurisë ku është ndërtuar pallati, të cilën e kalon në pronësi të shoqërisë së ndërtimit. Në bazë të kontratës të mësipërme janë lëshuar edhe certifikatat e pronësisë në emër të pronares F. K. . Palët deklarojnë se janë dakord me kalimin e pronësisë së sendeve në gjendjen që janë (pa vërejtje), por nuk deklarojnë gjendjen e tyre dhe as ndonjë ndërhyrje shtesë nga palët.

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “3. *Shtuar pasuria: një ambient social, zyrë 20 m² që përfiton bashkëshortja nga ndërtimi në pronën e saj, kontrata nr. (***)*, datë 22.9.2003 ku dhe banoj, dhënë nga firma ndërtuese me qira. Objekti ende i paregjistruar. Nga prill 2010”.

Nga mënyra e deklaramit, konstatohet se: subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi as apartament dhe as garazh si pasuri në posedim në vitin 2010.

Subjektit iu kërkuan sqarime mbi kohën kur këto pasuri janë marrë në dorëzim nga subjekti si dhe mbi gjendjen e tyre në momentin e marrjes në dorëzim.

Për sa më sipër, subjekti ka sqaruar se³²:

“Dorëzimi i apartamentit është bërë i përfunduar nga shoqëria ndërtuese në korrik 2005.....

²⁹ Shihni kontratën nr. (***), datë 2.12.2002.

³⁰ Shihni kontratën e shkëmbimit nr. (***), datë 5.11.2013.

³¹ Shihni kontratën nr. (***), datë 2.12.2002.

³² Subjekti i rivlerësimit i ka bashkangjitur pyetësorit: aktkontrollin, nr. K(***), datë 29.7.2004, të Bashkisë Tiranë; procesverbal, datë 29.6.2005, nga shoqëria ndërtuese “(***)” sh.p.k., deklaratën e administratorit të shoqërisë ndërtuese “(***)” sh.p.k.

Dorëzimi i apartamentit, si për bashkëshorten time F. K., dhe të gjithë banorët, është bërë nga shoqëria ndërtuese, pa nje akt me shkrim.

*Kontrata e shkëmbimit me shoqërinë “(***)” shpk, është nënshkruar vite më vonë, pasi shoqëria ndërtuese, nuk mund të rregjistronte objektin për shkak të ndërtimit mbi lejen e miratuar.*

*Në datën 5.11.2013, familja ime kishte 8 vite që banonte në atë apartament, dhe në të nuk është bërë asnjë ndryshim, nga dorëzimi prej shoqërisë “(***)” shpk.*

*Kam deklaruar rregullisht në deklaratimet periodike që nga ai i vitit 2006, si adresë banimi të familjes sime, Njësia(***), rr” (***)”, pall.” (***)” që është prona e mësipërme.”*

Nga sqarimi i mësipërm dhe nga deklarimi i vitit 2005, rezulton se kemi përputhje mes tyre lidhur me adresën e banimit të deklaruar, por nga që nga ky vit e në vijim, nuk deklarohet e drejta e përdorimit të ambienteve të fituara me kontratën e mësipërme.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ASHK-ja Tirana Jug, veç sa më sipër, konstatohet se:³³

Me kontratën e sipërmarrjes nr. (***), datë 2.12.2002, bashkëpronarët e pasurisë truall me sip. 800 m² dhe shtëpi banimi 2-katëshe në Rr. “(***)”, Tiranë, kanë rënë dakord me shoqërinë “(***)” sh.p.k., që të përfitojnë prej kësaj të fundit pronësinë mbi sipërfaqe ndërtimore, në këmbim të lënies së pasurisë për ndërtimin e një godine shumëkatëshe nga kjo shoqëri.

Sipërfaqet ndërtimore janë:

- apartamente – sip. 800 m²;
- dyqane – sip. 300 m²; dhe
- garazhe – sip. 200 m².

(duke u specifikuar orientimet dhe kuotat për secilin lloj të sipërfaqeve).

Në këtë kontratë nuk përcaktohet se si(?) apo sa(?) do të përfitojë secili bashkëpronar, por secili prej tyre ka nënshkruar nga një aneks kontrate ku ka përcaktuar sipërfaqen përkatëse të ndërtimit që do të përfitojë në pronësi nga shoqëria “(***)” sh.p.k. Në këtë kontratë përfitimi i tyre është caktuar në raportin 30 %.

Nëna e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. K. H., ka qenë një nga bashkëpronarët me 1/4 pjesë takuese ideale dhe është nënshkruese e kontratës së sipërmarrjes nr. (***), datë 2.12.2002, ku sipas kësaj kontrate do të përfitonte (sipas raportit 1/4) nga shoqëria ndërtuese:

- apartamente – sip. 200 m²;
- dyqane – sip. 75 m²; dhe
- parkim – sip. 50 m².

Në vijim, znj. K. H., nga pjesa e saj takuese e bashkëpronësisë mbi pasurinë truall me sip. 800 m² plus ndërtesë 2-katëshe, nëpërmjet kontratës së dhurimit nr. (***), datë 22.9.2003, ka dhuruar 1/3 pjesë personit të lidhur, znj. F. K. dhe 1/3 pjesë kunatit të subjektit, z. E. H. . Në këtë kontratë shpreh miratimin edhe shoqëria “(***)” sh.p.k., për shkak se pasuria ishte barrësuar në favor të saj në funksion të kontratës së sipërmarrjes së vitit 2002.

Në dokumentin “*aneks i kontratës së sipërmarrjes*”, që kanë nënshkruar bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. F. K., dhe shoqëria “K.” sh.p.k. në vitin 2003 është përcaktuar kalimi i pronësisë për apartament me sipërfaqe:

- 87,74 m² (nga 66,67 m² që i takonte);
- dyqan/zyrë me sipërfaqe 20 m² (nga 25 m² që i takonte); dhe

³³ Komisioni – kërkesë nr. (***) prot. dt 2.5.2019 – drejtuar ZVRPP-së Tiranë.

ASHK, DV TR-Jug - kthim përgjigjeje nr. (***) prot., datë 6.6.2019 (Komisioni (***)) - regjistrimi fillestar i pallatit.

- 37 m² garazh (nga 16,7 m² që i takonte).
(sipas specifikimeve përkatëse të secilit ambient).

Në përfundim, bazuar në kontratën e shkëmbimit nr. (***) , datë 5.11.2013, mes bashkëshortes së subjektit, znj. F. K. dhe shoqërisë “(***)” sh.p.k. është realizuar kalimi i pronësisë së këtyre sipërfaqeve ndërtimore:

- 171,75 m² apartament (nga 66,67 m² që i takonin sipas kontratës së sipërmarrjes apo nga 87,74 m² që i takonin sipas aneksit të kontratës së sipërmarrjes);
- 20,2 m² njësi (ose dyqan) (nga 25 m² që i takonin nga kontrata e sipërmarrjes apo nga 20m² sipas aneksit të sipërmarrjes) dhe
- 31,72 m² garazh (nga 16,7 m² që i takonin nga kontrata e sipërmarrjes apo nga 37 m² sipas aneksit të sipërmarrjes).

Sipas aktkollaudimit të objektit (pallati), rezulton se i gjithë ndërtimi ka përfunduar në qershor të vitit 2005, ku evidentohet se në këtë periudhë janë përfunduar të gjitha punimet e brendshme dhe të jashtme, lidhjet e ujit me UKT-në dhe lidhjet energjisë elektrike me OSHEE-në, si dhe punimet infrastrukturore dhe dekorative rrotull objektit.

Nga sa më sipër, Komisioni konstatoi se në kontratën e vitit 2013 ka rritje substanciale të sipërfaqeve të përfituara nga personi i lidhur, të cilat nuk korrespondojnë me pjesën takuese të nënës së saj, sipas kontratës së sipërmarrjes.

Në lidhje me sa më sipër, Komisioni nëpërmjet pyetësorit nr. 5, kërkoi nga subjekti i rivlerësimit që të qartësohet marrëdhënia e vjehrrës së tij dhe e personit të lidhur (në njëerën anë) me shoqërinë e ndërtimit dhe me bashkëpronarët e tjerë (në anën tjetër), lidhur me sipërfaqet e përfituara në godinën e ndërtuar në truallin që kishin në bashkëpronësi.

Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka dhënë përgjigjet e tij në datën 17.6.2019, nëpërmjet të cilave (përmbledhur) deklaroi se:

- Rritja e sipërfaqeve të ndërtimit të përfituara nga bashkëshortja janë rezultat i përfitimit të pjesëve takuese të nënës së saj, e cila i kishte kaluar 1/3 asaj sipas kontratës së dhurimit nr. (***) , datë 22.9.2003.

- Kjo rritje është rezultat i realizimit të një ndërtimi më të madh nga projekti fillestar nga shoqëria ndërtuese, rast për të cilin, bazuar në nenin 4.4 të kontratës së sipërmarrjes nr. (***) , datë 2.12.2002, u jepte bashkëpronarëve të drejtën që të ruajnë të pacenuar sipërfaqen e përfitur sipas nenit 4.1 të kontratës, si dhe të shtojnë përfitimin në raportet e përcaktuara 30 % të ndërtimit për bashkëpronarët e truallit dhe 70 % për shoqërinë ndërtuese.

- Si rezultat i gabimeve materiale të noterës e cila ka hartuar kontratën dhe të ZVRPP-së Tiranë që ka regjistruar pronën kanë ndodhur mospërputhjet mes sipërfaqeve të anekseve të kontratës dhe certifikatave të regjistrimit të pasurisë.

- Një tjetër element që ka ndikuar në krijimin e ndryshimeve të sipërfaqeve të rena dakord në kontratën e sipërmarrjes së vitit 2002 (në njëerën anë) dhe sipërfaqeve të përcaktuara në anekset e kontratës me secilin bashkëpronar (në anën tjetër), janë konvertimet mes, p.sh.: sipërfaqeve garazh apo dyqan, me sipërfaqe apartament dhe anasjelltas.

Të njëjtin qëndrim subjekti i rivlerësimit mbajti edhe në seancën dëgjimore të datës 6.11.2019 përpara Komisionit. Në seancë dëgjimore subjekti ka dhënë sqarime mbi provat e depozituara gjatë hetimit nga të cilat rezulton se shoqëria e ndërtimit ka realizuar *de facto* një ndërtesë me sipërfaqe më të madhe nga sa kishte të miratuar në bazë të lejes së ndërtimit (subjekti i rivlerësimit dhe përfaqësuesi ligjor i shoqërisë së ndërtimit kanë shpjeguar se pallati është ndërtuar me kate shtesë, dhe nuk ka asnjë nga shkallëzimet vertikale që do të kishin qenë nëse

do të ishte ndërtuar sipas lejes së miratuar nga Bashkia Tiranë). Për këtë arsye, shoqëria ndërtuese ka përmbyllur procedurat për deklarimin e ndërtimit pranë ALUIZNI-t, si dhe formalitetet e tjera deri sa u përfitua leja e legalizimit, fakt që konfirmohet nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ALUIZNI Tirana – 2³⁴.

Komisioni hetoi në mënyrë të veçantë mbi ekzistencën e rrethanave të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit me shoqërinë ndërtuese (dhe përfaqësuesin e saj) apo të trajtimit preferencial të bashkëshortes së tij, bazuar në pozitën e tij si magjistrat³⁵.

Gjithashtu, Komisioni, pas riçeljes së hetimit në bazë të kërkesës së subjektit të rivlerësimit, ftoi për të dëshmuar shtetasin B. K., përfaqësues ligjor i shoqërisë “(***)” sh.p.k., i cili dha deklarimin e tij përpara Komisionit. Deklarimet e shtetasin B. K. përputhen me shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit.

Nga përgjigjet e institucioneve të cilave u ishte drejtuar kërkesa për informacion dhe dokument, nuk rezultuan fakte apo *indicie* mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në procese ku palë ndërgjyqëse të kishte qenë shoqëria ndërtuese dhe ose përfaqësuesi i saj.

Po kështu, nga deklarimi i shtetasit B. K. nuk rezultuan fakte apo *indicie* nga të cilat ky i fundit të ishte nënshtruar ndaj ndonjë presioni të ushtruar nga subjekti i rivlerësimit, për shkak të pozitës së tij si magjistrat. Ai theksoi faktin se pallati që ndërtoi ishte më i madh nga sa ishte parashikuar në lejen e ndërtimit, shtesë që më pas është legalizuar duke u paguar edhe detyrimet përkatëse, fakt për të cilin pronarëve të truallit u takonte një sipërfaqe ndërtimore më e madhe, në përputhje me raportin e vendosur që në kontratën e vitit 2003³⁶.

Nga provat e administruara dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe në seancë gjyqësore, referuar sa më sipër, Komisioni krijoi bindjen se kontrata përfundimtare e shkëmbimit nr. (***) , datë 5.11.2013, mes personit të lidhur F. K. dhe shoqërisë “(***)” sh.p.k., përbën akt civil volitiv – shprehje të vullnetit të lirë të palëve në një veprim juridik që përmbush kushtet e parashikuara në nenin 663, të Kodit Civil.

Pronësia mbi apartamentin, njësinë (zyrë) dhe garazhin, si dhe mënyra e krijimit të tyre, konfirmohet me shkresën nr. (***) prot., datë 22.10.2018 nga ZVRPP-ja Tiranë, si dhe materialet bashkëlidhur.

Për sa më sipër, Komisioni çmon se duke marrë në konsideratë se:

- Personi i lidhur ka deklaruar lidhur me marrëdhënien juridike të nënës së saj me subjektin ndërtues dhe kontratën e dhurimit që në deklarimin e parë periodik të bërë nga subjekti pikërisht në vitin 2003;
- Kontratat përkatëse janë akte që janë vlerësuar si të ligjshme komfor legjislacionit në fuqi dhe nuk janë kundërshtuar as nga subjekti ndërtues dhe as nga pronarët e truallit;
- Në analizë të pjesëve takuese të parashikuara, si në kontratën e parë të sipërmarrjes, e cila ishte lidhur pa një projekt konkret nga sipërmarrësit, të faktit se ndërtimi ka qenë në tejkalim të lejes së ndërtimit dhe për këtë ka një leje legalizimi, analiza e sipërfaqeve

³⁴ Shihni shkresën nr. (***)prot., datë 16.10.2018, kthim përgjigjeje nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t; shkresën nr. (***) prot., datë 23.10.2018, kthim përgjigjeje nga ALUIZNI, Tirana -2, si dhe materialet bashkëlidhur.

³⁵ Komisioni - kërkesë nr. (***) prot., datë 15.5.2019 - Gjykata Rrethit Tiranë.
GJYKATA RRETHIT TIRANE – kthim përgjigjeje nr. (***) prot., datë 28.5.2019.

Komisioni - kërkesë nr. (***) prot., datë 15.5.2019 - Prokuroria Përgjithshme.
PROKURORIA PERGJITHSHME – kthim përgjigjeje nr. (***) prot., datë 27.9.2019.
Komisioni - kërkesë nr. (***) prot., datë 15.5.2019 - Prokuroria e Krimeve të Rënda.
Prokuroria Shkalla e Parë për Krimet – kthim përgjigjeje nr(***) prot., datë 29.5.2019.

³⁶ Shihni - procesverbal nr. (***) prot., datë 9.9.2019 – deklaratë, datë 29.8.2019, B. K.
- Procesverbal nr. (***)prot., datë 9.9.2019 – deklaratë, datë 9.9.2019, B. K. .

përfituese nuk mund të bëhet duke iu referuar kontratës së sipërmarrjes, e lidhur kjo në një situatë faktike shumë të ndryshme nga ajo në momentin e shkëmbimit;

- **Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë pasurinë në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe nuk ka *indicie* për trajtim preferencial të personit të lidhur për shkak të pozitës së tij.**

Një tjetër aspekt i hetimit administrativ lidhet me kohën e vënies në zotërim/posedim të pasurisë, për të cilën, subjekti i rivlerësimit ka dhënë sqarimet e tij, konkretisht:

Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Dorëzimi i apartamentit është bërë i përfunduar nga shoqëria ndërtuese në korrik të vitit 2005. Në këtë periudhë, familja ime si dhe pothuaj të gjithë banorët, pavarësisht bashkëpronarë ne truell, apo blerës të apartamenteve, kanë hyrë dhe banonin në apartamentet e tyre”*.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 5, subjekti i rivlerësimit konfirmon: *“Dorëzimi nga shoqëria ndërtuese i ambienteve, si kam deklaruar edhe më parë, është bërë rreth muajit Korrik 2005. Në këtë periudhë, familja ime si dhe pothuaj të gjithë banorët, kanë hyrë dhe banonin në apartamentet e tyre.*

Dorëzimi si për bashkëshorten time F. K., dhe të gjithë banorët, është bërë nga shoqëria ndërtuese, pa nje akt me shkrim”.

Të njëjtin qëndrim, subjekti ka mbajtur edhe në seancë dëgjimore.

Në deklaratën periodike të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Pasuritë e tjera të luajtshme e të paluajtshme nuk kanë ndryshime”*. Kjo deklaratë rezulton që të jetë plotësuar dhe dorëzuar në datën 24.3.2006, pra, pas afro 9 muajve nga muaji korrik i vitit 2005 që subjekti kishte marrë në dorëzim pasuritë e paluajtshme në pallatin në fjalë. Në deklaratimet periodike pararendëse, subjekti ka deklaruar si pasuri të paluajtshme vetëm apartamentin në Rr. “(***)” dhe automjetin e blerë nga shtetasi S. P., si dhe të drejtën e bashkëpronësisë së bashkëshortes mbi pasurinë truell me sipërfaqe 800 m² dhe shtëpi 2-katëshe në Rr. “(***)”.

Ndërkohë, në vitin 2005, kjo pasuri ka pësuar ndryshime (sepse është zhvilluar) dhe për rrjedhojë edhe të drejtat e personit të lidhur kanë ndryshuar, duke qenë se në këtë vit, ajo merr në dorëzim sipërfaqet ndërtimore nga shoqëria “(***)” sh.p.k. Por, subjekti e deklaroi pasurinë e përfutur nga kontrata e sipërmarrjes, aneksin e sipërmarrjes dhe shkëmbimit vetëm në vitin 2013.

Në deklaratën e pasurisë të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“3. Shtuar pasuria: një ambient social, zyrë 20 m² që përfiton bashkëshortja nga ndërtimi në pronën e saj, kontrata nr. (***) , datë 22.9.2003 ku dhe banoj, Objekti ende i paregjistruar. Nga prill i vitit 2010”*.

Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka sqaruar: *“Kam deklaruar rregullisht në deklaratimet periodike që nga i vitit 2006, si adresë banimi të familjes sime, Njësia (***) , Rr. “(***)” , pall. “(***)” që është prona e mësipërme.”*

Në seancë dëgjimore subjekti është shprehur se:

Detyrimi për të deklaruar të drejtat reale mbi pasurinë i kanë lindur subjektit në vitin 2005 (viti i krijimit), sipas germës “a”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, sipas të cilit:

“Subjektet e përcaktuara ne nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.....:

- a) *pasuritë e paluajtshme dhe te drejtat reale mbi to”*.

Nga sa më sipër, rezulton se:

➔ **Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë në vitin 2005, vit në të cilin duhej që të deklaronte të gjitha pasuritë që kishte marrë në zotërim, situatë e cila, në fakt, riparohet prej tij në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013. Pasaktësitë në deklaramet, ndër vite të ndryshimit të pasurive dhe interesave të subjektit të rivlerësimit do të çmohen nga Komisioni në vlerësimin përfundimtar.**

7. Gjendje e depozitës në “Intesa SanPaolo Bank” është 14.503 euro (më 29.1.2015 depozituar shuma 7.000 euro, dhe më 4.1.2017 shuma 7.500 euro), në emër të bashkëshortes së subjektit, znj. F. K. .

Burimi i krijimit: këto shuma vijnë pjesërisht nga *cash* të deklaruar në vitet 2013, 2015 dhe pjesërisht nga kursimet familjare në vitet 2014 dhe 2016).

Pjesa takuese: zotërimi 100 %.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit

Pas verifikimit të gjendjes së llogarisë në bankë³⁷, konfirmohet shuma e deklaruar nga subjekti në deklaratën “Vetting”.

Nga sa më sipër, rezulton se:

- ✓ **Subjekti ka deklaruar saktë gjendjen e depozitës në shumën 7.000 euro në “Intesa Sanpaolo Bank”.**
- ✓ **Subjekti ka deklaruar kursime nga burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kësaj shume.**

8. Depozitë në shumën 4.933.244 lekë në emër të bashkëshortes së subjektit, znj. F. K., në “ProCredit Bank”.

Kjo depozitë është hapur në vitin 1999 në Bankën e Kursimeve, dyemërore me bashkëshortin në shumën 256.448 lekë, nga kursimet.

- Depozita u transferua të “Raiffeisen Bank” dhe në vitin 2003, depozita u shtua me 1.500.000 lekë, të përfituara nga zgjidhja e konfliktit me vendim nr. (***) , datë 25.2.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Depozita e mësipërme u kalua në datën 12.7.2009 të “ProCredit Bank” me ndryshimet e deklaruar ndër vite, si pasojë e interesave dhe derdhjeve të kursimeve (kjo depozitë me hyrjet dhe interesat në vite pasqyrohen në *statement* e datave 4.11.2016 dhe 4.1.2017, përbën shumën totale të deklaruar më lart). Zotërimi: 100%.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit

Pas verifikimit të gjendjes së llogarisë në bankë³⁸ konfirmohet shuma e deklaruar nga subjekti në deklaratën “Vetting”.

Nga sa më sipër, rezulton se:

- ✓ **Subjekti ka deklaruar saktë gjendjen e depozitës në shumën 4.933.244 lekë në “ProCredit Bank”.**

³⁷ Shihni shkresën nr. (***) prot., datë 8.10.2018, drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë dhe përgjigjen me shkresën nr. (***) prot., datë 18.10.2018, nga “Intesa Sanpaolo Bank”, si dhe materialet bashkëlidhur

³⁸ Shihni përgjigjen me shkresën nr. (***) prot., datë 11.10.2018, nga “ProCredit Bank”, si dhe materialet bashkëlidhur

- ✓ Subjekti ka deklaruar kursime nga burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kësaj shume.

9. Llogari rrjedhëse në “BKT”, datë 4.1.2017, në shumën prej 540.954,42 lekësh në emër të znj. F. K. . person fizik. Kjo shumë fillon nga viti 2013, në realizim të aktivitetit të përditshëm si noter, person fizik. Zotërimi: 100 %.

Nga sa më sipër, rezulton se:

- ✓ Subjekti ka deklaruar saktë gjendjen e llogarisë së bashkëshortes në “BKT”.
- ✓ Personi i lidhur ka deklaruar të ardhura nga burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kësaj shume.

DEKLARIMI I DJALIT TË SUBJEKTIT – R. K. – PERSON I LIDHUR

10. Bursë, si student i ekselencës, në Universitetin Publik Tiranë. Bursa derdhet nga universiteti në llogari të R. K. në “Credins Bank” dhe është në vlerën mujore 8.900 lekë.

Personi i lidhur i ka bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim nga Fakulteti i Drejtësisë, sipas të cilit R. K. ka përfituar bursë financiare, sipas VKM-së nr. 911, datë 11.11.2015, për vitin akademik 2015 – 2016, dhe *statement* “Credins Bank” për kalimin e bursës.
- Vërtetim nga Fakulteti i Drejtësisë Tiranë dhe nxjerrje llogarie nga “Credins Bank”, datë 18.10.2016

Hetimi i kryer nga Komisioni³⁹

Pas verifikimit të gjendjes së llogarisë në bankë konfirmohet shuma e deklaruar nga subjekti në deklaratën “Vetting”.

Nga sa më sipër, rezulton se:

- ✓ Subjekti ka deklaruar saktë gjendjen e llogarisë së të birit në “Credins Bank”.
- ✓ Personi i lidhur ka deklaruar kursime nga burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kësaj shume.

Analiza financiare përmblendhëse e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur

³⁹ Shihni shkresën nr. (***) prot., datë 8.10.2018, drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë dhe përgjigjen me shkresën nr. (***)prot., datë 31.1.2018, nga “Credins Bank”, si dhe materialet bashkëlidhur.

Përshkrimi	para 2003	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
1 PASURI	1,283,333	1,858,193	412,079	398,669	716,987	481,943	477,172	444,792	1,731,344	493,733	113,343	748,256	-53,541	754,255	1,489,765
Apartament 2+1 ***, Tiranë përftuar nga privatizimi i banesave shtetërore, subjekti, 25% pjesa takuese	1,000,000														
Apartament 2+1 ***, Tiranë përftuar nga privatizimi i banesave shtetërore, bashkëshortja e subjektit, 20% pjesa takuese	200,000														
Shtëpi barimi 2 kate + një truall 800 m ² , ***, Tiranë	83,333														
Autoveturë e markës "Benz" 250			500,000												
Autoveturë e markës "Benz" 280 ***, blerë në 2010 në shumën 14.000 €									1,943,340						
Ambjent zyre 20 m ² të përftuara nga bashkëshortja nga ndërtimi në pronën e saj dhënë me qera nga firma ndërtuese															
Apartament barimi me numër pasurie *** në emër të bashkëshortes së subjektit përftuar nga kontrata e shkëmbimit me sip. 152.5 m ²															
Njësi me numër pasurie *** në emër të bashkëshortes së subjektit përftuar nga kontrata e shkëmbimit me sip. 20.2 m ²															
Garazh me numër pasurie *** në emër të bashkëshortes së subjektit përftuar nga kontrata e shkëmbimit me sip. 31.72 m ²															
Shtesa/pakësime likuiditete CASH dhe bankë		1,858,193	-87,921	398,669	716,987	481,943	477,172	444,792	-211,996	493,733	113,343	748,256	-53,541	754,255	1,489,765
2 DE TYRINE	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3 PASURI NETO	1,283,333	1,858,193	412,079	398,669	716,987	481,943	477,172	444,792	1,731,344	493,733	113,343	748,256	-53,541	754,255	1,489,765
4 TË ARDHURA	2,882,778	2,502,111	1,222,421	1,251,610	1,408,183	2,248,594	1,888,249	2,041,232	2,191,584	2,048,100	1,831,258	2,150,073	3,348,492	3,075,554	3,523,391
Të ardhura nga paga subjekti të dokumentuara	2,038,574	597,174	795,926	802,860	946,999	1,141,452	1,162,416	1,207,123	1,176,684	1,154,645	1,160,057	1,152,156	1,323,228	1,218,863	1,534,559
Të ardhura nga paga bashkëshortja e subjektit të dokumentuara	836,337	348,542	415,216	448,750	461,124	581,541	571,176	653,238	661,278	676,248	453,297				
Të ardhura nga puna si notere e bashkëshortes së subjektit të dokumentuara												760,819	1,596,194	1,776,680	1,793,128
Të ardhura nga dhurata nga mamaja e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në vitin 2007						400,000									
Të ardhura nga interesi i depozitave	7,867	56,395	11,279		60	125,601	154,657	180,871	256,422	217,207	217,904	237,098	137,470	80,011	87,244
Të ardhura nga qeraja bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit									97,200				291,600		108,460
Të ardhura të përftuara me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë		1,500,000													
5 SHPENZIME	0	375,456	375,456	623,942	1,042,058	1,188,832	840,595	843,302	665,857	1,054,433	840,628	998,747	1,064,937	1,190,299	1,194,676
Shpenzime jetese		375,456	375,456	438,228	438,228	943,872	546,480	546,480	546,480	546,480	564,096	564,096	879,992	897,104	940,368
Shpenzime arredimi				185,714	185,714	185,714	185,714	185,714		185,714	185,714				
Shpenzimet për udhëtime nga sistemi TMS					418,116	59,246	108,401	111,108	119,377	322,239	90,818	434,651	184,945	293,195	254,308
DIFERENCA (TË ARDHURA - PASURI - SHPENZIME 4-3-5)	1,599,445	268,462	434,886	228,999	-350,862	577,819	570,482	753,138	-205,617	499,934	877,286	403,070	2,337,096	1,131,001	838,950

Komisioni, gjatë procesit të rivlerësimit, hetoi lidhur me:

I. Në datën 17.5.2013 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është regjistruar kërkesëpadija e paditësit S. K., kundër Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për kompensimin e truallit me sip. 366 m², ndodhur në Tiranë, pronë e ish-pronarit H. K., babai i paditësit. Paditësi, në kërkesëpadi, përfaqësohet nga i biri, Artur Kalaja, subjekti i rivlerësimit.

Në datën 20.5.2013 gjyqtari i çështjes cakton seancën përgatitore me datë 29.5.2013. Përveç kësaj seance, gjyqtari ka zhvilluar edhe dy seanca të tjera, me datë 3.6.2013 dhe datë 10.6.2013, në të cilat është zhvilluar hetimi, janë administruar provat, janë zgjidhur kërkesat e palëve dhe madje gjykata ka marrë edhe një vendim të ndërmjetëm për sigurimin e padisë.

Në datën 10.6.2013 gjykata ka dhënë vendimin nr. (***), datë 10.6.2013, duke pranuar padinë dhe detyruar AKKP-në për t'i paguar paditësit shumën 24.000.000 lekë.

Në datat 13.6.2013 dhe 17.6.2013 janë depozituar ankimet e AKKP-së dhe të Avokaturës së Shtetit.

Në datën 17.7.2013 regjistrohet çështja në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Në datën 14.10.2013 çështja shorohet përsëri (pasi largohet nga trupi gjykues subjekti i rivlerësimit, i cili zëvendësohet me gjyqtar tjetër të asaj gjykate). Ndërkohë, në trupin gjykues janë dy nga anëtarët e trupit gjykues, me të cilët subjekti i rivlerësimit ka gjykuar për një periudhë të gjatë.

Në datën 16.10.2013 Gjykata e Apelit Tiranë zhvillon seancën gjyqësore dhe vendos lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në datat 17.10.2013 dhe 13.11.2013 janë depozituar rekursat e Avokaturës së Shtetit dhe të AKKP-së.

Në datën 16.4.2014 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. (***), datë 16.4.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmban shkaqet e parashikuara në ligj.

Shuma e përcaktuar në vendimin përfundimtar të gjykatës është ekzekutuar nga shërbimi përmbarrimor, e cila kaloi në një llogari bankare në përdorimin e subjektit të rivlerësimit dhe të babait të tij. Më pas subjekti transferon te trashëgimtarët e tjerë të të ndjerit H. K. shumat përkatëse, duke mbajtur një shumë të konsiderueshme, që nuk përputhet me pjesën prej 1/7-ën të trashëgimisë.

Për sa më sipër, subjektit iu komunikua rezultati i hetimit, si dhe konkluzioni paraprak (i mundshëm) i Komisionit, se në këtë rast, në gjykimin e çështjes gjyqësore në fjalë, si dhe në kuadër të mënyrës së ekzekutimit të vendimit, mund të kishte ndodhur trajtim preferencial dhe/ose përfitim i padrejtë për shkak të pozitës së subjektit si magjistrat⁴⁰, pasi:

i. i gjithë procesi ka zgjatur më pak se 11 muaj;

ii. gjykimi në shkallë të parë është realizuar pa u çmuar paraprakisht vlefshmëria e përfaqësimit të paditësit nga një gjyqtar apo bashkëshortja e tij (sipas nenit 96, të Kodit të Procedurës Civile), si dhe pa një ekspertizë për përllogaritjen e shumës së kompensimit objekt gjykimi (sipas nenit 224/a e vijues të Kodit të Procedurës Civile);

iii. gjykata e shkallës së parë disponon për sigurimin e kërkesëpadiës, duke sekuestruar llogari bankare të një institucioni publik në një shumë (24.000.000 lekë) për të cilën nuk kishte asnjë veprim procedural përllogaritës, si dhe pa arsyetuar mbi mundësinë apo rrezikun e

⁴⁰ Bazuar në: germën “F”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (shtuar me pikën 3, të nenit 3, të ligjit nr. 85/2012, datë 18.9.2012); germaën “d”, të nenit 103, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

mosekzekutimit të vendimit në favor të kërkuesit në të ardhmen (sipas nenit 202, të Kodit të Procedurës Civile);

iv. gjykimi në shkallë të parë është përmbyllur me tri seanca brenda 12 ditëve (kohëzgjatje e pakrahasueshme me çështjet e tjera të këtij lloji të po të njëjtit gjyqtar);

v. gjykimi në shkallë të dytë është kryer nga kolegët e subjektit të rivlerësimit (me të cilët gjykonte në të njëjtin trup gjykues, në periudhën përkatëse), të cilët e kanë gjykuar çështjen brenda më pak se tre muajve, duke përfshirë midis kësaj periudhe edhe mbi një muaj periudhë pushimi gjyqësor (d.m.th: muaji gusht e fillimi i muajit shtator i vitit 2014), kohëzgjatje e pakrahasueshme me çështjet e tjera të këtij lloji të po tre gjyqtarëve (më të zgjeruar, ngarkesën e subjektit e trajtojmë në vlerësimin e kriterit profesional) dhe të Gjykatës së Apelit Tiranë në tërësi (në lidhje me këtë rrethanë mbahet në konsideratë fakti se përveç zëvendësimit të subjektit të rivlerësimit me një gjyqtar tjetër, në vendim dhe në dosjen gjyqësore nuk ka asnjë referencë apo *indicie* mbi mënyrën e respektimit të neneve 72 e vijues të Kodit të Procedurës Civile dhe të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, nga anëtarët e trupit gjykues);

vi. gjykimi në shkallë të tretë është kryer në një hark kohor prej më pak se 5 muajsh (duke llogaritur pushimet e fundvitit dhe formalitetet e gjykatave për reregjistrimin e çështjeve në regjistrat e rinj, si dhe faktin që dosja gjyqësore nuk mund të dërgohet në Gjykatën e Lartë pa u plotësuar me rekursat e palës së paditur, AKKP-së dhe Avokaturës së Shtetit dhe komunikimin e tyre tek paditësi – çka kërkon kohë si procedurë), kohëzgjatje e pakrahasueshme me çështjet e tjera të këtij lloji të po atij trupi gjykues dhe të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në tërësi.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Pas komunikimit të rezultatit të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar me shkrim si vijon:

*“... KKKP-ja Tiranë, me vendimin nr. (***) , datë 31.7.1994, iu njohu trashëgimtarëve të të ndjerit H. K., të drejtën e pasurisë mbi një banesë dykatëshe, me 6 dhoma, 2 sallone etj., dhe truall me sip. 935.24 m², në Rr. “(***)”, Tiranë, duke ju kthyer fizikisht banesën dhe truallin me sip. 569.24 m² dhe duke ju njohur të drejtën e kompensimit për truallin me sip. 366 m².”*

Megjithë kërkesat në vijim të bashkëpronarëve për t’u kompensuar sipas vendimit, për mungesë fondesh, për rreth 20 vjet, kjo e drejtë nuk ishte e mundur të bëhej efektive.

Ndërkohë, nga publikimet e vendimeve që kishin përfituar kompensim në shtypin periodik, por edhe buletinet përkatëse, rezultoi se kompensim kishin marrë edhe ish-pronarë me vendime me datë shumë më të vonshme se data 31.7.1994.

Fakti i mësipërm tregon se për bashkëpronarët Kalaja, jo vetëm nuk kishte ndonjë trajtim preferencial, por në shkelje të procedurave ligjore po ju zvarritej ekzekutimi i një të drejte të ligjshme të fituar prej 20 vitesh.

Sipas kuadrit ligjor të kohës, AKKP-ja kishte detyrimin që për pronarët që kishin marrë të drejtën e kompensimit deri në 500 m², të kompensonte 200 m².

Nga ana tjetër, në rastet që AKKP-ja nuk ushtronte këtë detyrim, pronarët që e bënë çështjen konflikt gjyqësor, në përgjithësi, kërkonin të drejtën e kompensimit për të gjithë sipërfaqen që ajo ishte njohur.

Në të kundërt, me praktikën e sa më sipër, bashkëpronarët Kalaja kishin kërkuar në gjykim, të drejtën të kompensoheshin vetëm për 200 m², sipas detyrimit të AKKP-së, dhe jo për 366 m², që gëzonin këtë të drejtë.

Po kështu, në atë periudhë Këshilli i Ministrave kishte miratuar sipas hartës së zonave edhe vlerën respektive të trojeve që duhet të përdorte AKKP-ja për kompensim.

Ndërkohë, në konfliktet gjyqësore palët, referuar Kushtetutës dhe Kodit Civil, por edhe praktikës së GJEDNJ-së, në përgjithësi kërkonin që vlera e kompensimit të llogaritej me vlerën e tregut të truallit që kompensohej.

Edhe në këtë rast, bashkëpronarët Kalaja, në të kundërt, kërkuan në gjykatë që kompensimi të llogaritej në bazë të VKM-së, siç kishte detyrimin AKKP-ja, dhe jo vlerës së tregut që realisht ishte më e madhe.

Në rrethanat si më sipër, ky gjykim ishte proceduralisht i thjeshtë dhe kthehej përveç konstatimit të ekzistencës të së drejtës, që vërtetohej më vendimin e KKKP-së, në një shumëzim të 200 m², me vlerën sipas VKM-së.

Këtë kërkim ka pranuar gjykata dhe për këtë shkak subjekti vlerëson se nuk ka pasur nevojë për njohuri të posaçme dhe caktim eksperti.

Lidhur me ekzekutimin e këtij vendimi, subjekti sqaron se veprimet e përmbaruesit privat për sekuestrimin e llogarisë së AKKP-së, megjithëse në vlerësimin e tij janë të drejta, kanë qenë thjesht veprime rutinë të përmbaruesit, që vendoste sekuestro në llogari bosh, ndërkohë që *ekzekutimi është bërë vetëm në vitin 2015, kur AKKP-ja hapi vetë fondin për këtë qëllim.*⁴¹

Në vijim të parashtrimeve, subjekti shprehet:

“Lidhur me shumën e mbetur në llogarinë e babait tim, shumë që në dijeninë time është akoma në të njëjtën llogari, më duhet të sqaroj fillimisht se unë si kam deklaruar në mënyrë të shprehur në deklaratën ‘Vetting’ se ... asnjë pjesë e kësaj shume nuk ka qenë dhe as është e imja dhe emri im figuron vetëm si përfaqësues i babait S. K. .

Ndërkohë, nëse do t’i referoheni numrit të bashkëpronarëve, do të konstatoj se veç bashkëpronarit S. K., pjesën e tij në shumën gjendje në llogari, për probleme personale të tij, nuk e ka tërhequr edhe një tjetër bashkëpronar.

Për pjesën që mbetet më zbritjen e shumave të këtyre dy bashkëpronarëve, në dijeninë time, ata kanë vlerësuar se fillimisht duhet bërë një llogari mbi shpenzimet lidhur me këtë pronë.

Kështu, për pronën në fjalë janë bërë aplikime dhe gjykime lidhur me vendimin e KKKP-së, pasi fillimisht sipas ligjit të kohës dhe statusit të ish-pronarit Seksioni i Financave, Bashkia Tiranë, e pati kthyer për korrigjimin e hartës së këtij vendimi, për qiramarrësit shtetërorë në këtë pronë dhe deri për kompensimin e pjesës së saj, procese të cilat kanë pasur shpenzimet e tyre dhe janë ndjekur nga disa bashkëpronarë.

Më tej, një shumë të mbetet e gatshme për dokumentacionin e rastit, pasi për pronën prej kohe janë në tentativa zhvillimi”⁴².

Për sa më sipër, Komisioni kishte bërë verifikimet përkatëse, nga të cilat rezultoi se qëndrimet e subjekti të rivlerësimit përputhen me dokumentacionin e dosjes gjyqësore dhe me dokumentacionin bankar.

Nga sa më sipër:

→ Në përfundim, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar, si dhe të deklarimeve të subjektit gjatë hetimit administrativ, nuk rezultuan prova apo *indicie* që t’i krijonin Komisionit bindjen se subjekti i rivlerësimit mund të kishte përfituar ndonjë trajtim preferencial apo mund të kishte ushtruar ndikim, duke shfrytëzuar pozitën e tij si magjistrat për përfitime të padrejta, në kuadër të

⁴¹ Komisioni e çmon parashtrimin e mësipërm në lidhje me besueshmërinë në ligj të vendimit të ndërmjetëm të gjykatës për sigurimin e padisë nëpërmjet sekuestrimit të llogarisë bankare në shumën 24.000.000 lekë.

⁴² Komisioni e çmon parashtrimin e mësipërm në lidhje me destinacionin e mëtejshëm të shumës që rezultoi nga ekzekutimi i vendimit të gjykatës.

procedurave të sa më sipër referuar (gjqësore, përmbarimore dhe të destinacionit të shumës së ekzekutuar), të zhvilluara në emër dhe për llogari të babait të tij.

II. Gjatë hetimit administrativ, nga materialet e vëna në dispozicion nga ZVRPP-ja Tiranë, ka rezultuar gjithashtu se: në bazë të kontratës së shitblerjes nr. (***) , datë 23.12.2010, shitëset Z., E. dhe A. T. (trashëgimtarë të shtetasit A.T.) kanë fituar nga trashëgimia e të ndjerit 1/20 pjesë takuese të truallit me sip. 800 m², e barabartë me 40 m², nga e cila i shesin blerësit S. K. (babai i subjektit të rivlerësimit) 1/2 pjesë ideale saj, kundrejt çmimit 2.500.000 lekë. Në këtë kontratë është palë edhe shoqëria e ndërtimit “(***)” sh.p.k., e cila jep pëlqimin për këtë transaksion, duke qenë se prona rezulton e bllokuar me barrë hipotekore në favor të saj, për shkak të ndërtimit. Palët nënshkruese deklarojnë në faqet 2-3 të kontratës se nga kontrata e sipërmarrjes⁴³ blerësit S. K. do t’i kalojë pronësia e një apartamenti me sip. 55 m², që shitësit do të përfitonin në atë pallat, ndërsa pjesa e mbetur u mbetej atyre.

Kjo kontratë është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, e cila ka vepruar me njohjen e transaksionit dhe shënimin e emrit të blerësit si bashkëpronar mbi truallin e dhënë për ndërtim.

Konstatohet se qëllimi i kontratës së shitblerjes është përfshirja drejtpërdrejt e blerësit S. K. në marrëdhënien e shkëmbimit si bashkëpronar i pasurisë që zhvillohet me shoqërinë investitore/ndërtuese, fakt që del edhe nga kontrata. Nëse i referohemi dispozitave të Kodit Civil, konkretisht neneve 200/c dhe 204 të tij, vërejmë se shitësit kanë disponuar mbi një kuotë ideale të një sendi në bashkëpronësi nëpërmjet shitjes, të cilën më parë duhej që t’ua ofronin për të njëjtin çmim bashkëpronarëve të tjerë.

Në këtë mënyrë, pa diskutuar mbi aspekte të përputhshmërisë së këtij veprimi me dispozitat e Kodit Civil mbi bashkëpronësinë, babai i subjektit të rivlerësimit është bërë *ipso acta* bashkëpronar në pasurinë në fjalë me 1/40 pjesë ideale të bashkëpronësisë, çka e legjitimonte që të përfitonte nga sipërfaqet ndërtimore (apartamente, njësi/dyqane, garazh) në raport të drejtë me pjesën e tij takuese, ose:

- 20 m² apartament;
- 7,5 m² dyqan/njësi;
- 5 m² garazh.

Vetëkuptohet që në sipërfaqe të tilla ndërtimore është i pamundur shfrytëzimi sipas destinacionit. Megjithatë, në këtë kontratë palët kanë përcaktuar edhe përfitimin konkret nga shkëmbimi final mes babait të subjektit dhe shoqërisë “(***)” sh.p.k., e cila është një apartament me sip. 55 m² në të njëjtin pallat, sipas specifikimeve.

Me kontratën e shkëmbimit⁴⁴, shoqëria “(***)” sh.p.k., bazuar në kontratën e sipërmarrjes, kalon në pronësi të bashkëpronarit S. K. këtë pasuri (që i përket pallatit të ndërtuar në pasurinë e sipërcituar):

- **Apartament me sip. 56,77 m²**, nga të cilat 50 m² sipërfaqe banimi dhe 6,77 m² sipërfaqe të përbashkëta, regjistruar në ZVRPP-në Tiranë si pasuria nr(***) , vol. (***) , f. (***) , z.k. (***) .

Kontrata rezulton të jetë regjistruar rregullisht në ZVRPP-në Tiranë, e cila ka lëshuar certifikatë pronësie për apartament me sip. 58 m² (pra, për një apartament me sipërfaqe neto më të madhe nga ajo e kontratës së sipërmarrjes së vitit 2002, se ajo e shitblerjes së vitit 2010 dhe e shkëmbimit të vitit 2012).

Nga sa më sipër, konstatohen rritje thelbësore të sipërfaqeve të përfituara nga babai i subjektit të rivlerësimit, të cilat nuk korrespondojnë me pjesën takuese të tij, apo të bashkëpronarëve pararendës të tij, sipas kontratës së sipërmarrjes. Mes z. S. K. dhe shoqërisë “(***)” sh.p.k. (apo mes kësaj të fundit dhe bashkëpronarëve Z., E. dhe A. T.) nuk ekziston asnjë akt juridik

⁴³ Shihni kontratën nr. (***) , datë 2.12.2002.

⁴⁴ Shihni kontratën e shkëmbimit nr. (***) , datë 17.12.2012 dhe kontratën e sipërmarrjes nr. (***) , datë 2.12.2002.

për kompensim apo konvertim të sipërfaqeve ndërtimore, me qëllim realizimin e përfitimit të apartamentit në sipërfaqen 55 m².

Në kontratë evidentohet se shkëmbyesi S. K. zotëron 1/11 pjesë të pasurisë ku është ndërtuar pallati, të cilën e kalon në pronësi të shoqërisë së ndërtimit. Në bazë të kontratës të mësipërme është lëshuar edhe certifikata e pronësisë në emër të pronarit S. K.. Palët deklarojnë se janë dakord me kalimin e pronësisë së sendit në gjendjen që është (pa vërejtje), por nuk deklarojnë gjendjen e tij dhe as ndonjë ndërhyrje shtesë nga palët.

Gjithashtu, Komisioni krijoi dyshimin se babai i subjektit mund të kishte përfituar ndonjë trajtim preferencial apo subjekti mund të kishte ushtruar ndikim për përfitim të padrejtë për babain e tij, duke shfrytëzuar pozicionin e magjistratit, pasi u konstatua se:

- bashkëpronarët nuk kishin respektuar kërkesat e germës “c”, të nenit 200 dhe nenit 204 të Kodit Civil, për t’ua ofruar për shitje pjesën e tyre fillimisht bashkëpronarëve të tjerë;
- nënshkrimi i kontratës së shitblerjes nr(***), datë 23.12.2010 është realizuar në kushte të paqarta lidhur me objektin, pasi trualli nuk ishte i lirë (mbi të ishte ndërtuar pallati).

Gjatë hetimit administrativ Komisioni kërkoi sqarime nga subjekti i rivlerësimit lidhur me konstatimet e mësipërme dhe, ndër të tjera, në përgjigje të këtij pyetësi ka deklaruar se⁴⁵: “...shitësit Z., E. dhe A. T. (trashëgimtarë të shtetasit A. T.), i shesin blerësit S.K. 1/2 pjesë ideale të tyre në pasurinë truall me sip. 800 m². Po në këtë kontratë palët kanë përcaktuar se për pjesën e blerë, blerësit S. K. do t’i kalojë pronësia e një apartamenti me sip. 55 m², që shitësit do të përfitonin në atë pallat, që ndërtohej sipas kontratës së sipërmarrjes nr. (***), datë 2.12.2002, nga shoqëria ‘(***)’ sh.p.k., ndërsa pjesa e mbetur do të vijonte t’u mbetej atyre... Objekti, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. (***), datë 2.12.2002, ishte i ndërtuar, por për faktin se nuk ishte regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, rezultonte ende trualli me sip. 800 m², i bllokuar për ndërtim. Në këto kushte, në formë ligjore, akti për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme dhe regjistrimi mund të bëhej vetëm duke tjetërsuar pasurinë e regjistruar, duke specifikuar qëllimin e palëve, si dhe dakordësinë e subjektit ndërtues të plotësonte këtë qëllim kur të regjistronte objektin. Që kontrata u nënshkrua në vitin 2010, lidhet me faktin se mes tij dhe ndërtuesit kishte mosmarrëveshje për pjesën takuese. Në fakt, pjesa që ka përfituar S. K., nuk është një apartament 50 m², por pjesë e një apartamenti, nga i cili rreth 30 m² ndërtuesi ia kishte bashkëngjitur apartamentit fqinj, që ia kishte shitur të tretëve. Pas vdekjes së të ndjerit A. T. në datën 20.11.2009, bashkëshortja dhe vajzat, që jetojnë ne Itali, vlerësuan të mbyllin këtë mosmarrëveshje dhe nënshkruan me z. S. K. për pjesën e banimit dhe në dijeninë time, pjesët e tjera i ka mbajtur ndërtuesi, duke i kompensuar në vlerë... Lidhur me pjesën prej 1/11 pjesë të truallit, në kontratën e shkëmbimit, vlerësoj se është një gabim material i noteres. Nga vërtetimi hipotekor më rezulton se vetë i ndjeri A. T. ka pasur 1/20 pjesë.”

Në kuadër të përgjigjeve në pyetësin nr. 5, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: “Unë vlerësoj se në rastin më të mirë këto janë pasaktësi, ashtu si dhe S. K., në atë kontratë figuron bashkëpronar në 1/11 pjesë të truallit, gjë që nuk është e saktë, ose, në kushtet kur pronarët e apartamenteve nuk është se kanë ndonjë interes, llogaritja e sipërfaqeve të përbashkëta bëhet formale, për gjithë objektin, dhe më pas iu ndahet njësisë pa ndonjë kriter.

Në të kundërt, përveç një gabimi material, nuk ka asnjë shpjegim tjetër se si kontrata e shkëmbimit nr. (***), datë 12.12.2012, e dërguar në ZVRPP-në Tiranë, nga ndërtuesi apo noteri, e shoqëruar me certifikatën e pronësisë për pasurinë nr. (***), vol. (***), f. (***), apartament me sip. 50,00 m², në pronësi të ‘(***)’ sh.p.k., lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë në datën 24.5.2012, kthehet e shtuar nga ZVRPP-ja në certifikatën e pronësisë për të njëjtën pasuri nr. (***), vol. (***), f. (***), apartament me sip. 58,00 m², në pronësi tashmë të S. K., lëshuar po nga ZVRPP-ja Tiranë, në datën 7.1.2013, pra, vetëm pak ditë pasi ishte nënshkruar kontrata e shkëmbimit”.

⁴⁵ Subjekti ka bashkëlidhur në përgjigje të pyetësit nr. 2 deklaratën noteriale nr. (***), datë 28.3.2019; vërtetimin hipotekor datë 6.10.2003 dhe deklaratën e administratorit të shoqërisë ndërtuese “(***)” sh.p.k.”

Në dispozicion të Komisionit, nga ASHK-ja, Tirana Jug, u vendos dokumentacioni i plotë për sa i takon zhvillimit të pronës së familjes T. në Rr. “(***)”, që nga regjistrimi fillestar nr. (***), datë 7.10.2002, dhe deri në momentin aktual, përfshirë dokumentacionin teknik dhe ligjor të regjistrimit fillestar të pallatit, si dhe të gjitha kontratat e shkëmbimit që shoqëria “(***)” sh.p.k. ka nënshkruar me pronarët e truallit.

Nga provat e administruara dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe në seancë dëgjimore, referuar sa më sipër, Komisioni krijoi bindjen se kontrata shitblerjes nr. (***), datë 23.12.2010 mes shitësve Z., E. dhe A. T. dhe S. K., si dhe kontrata përfundimtare e shkëmbimit nr. (***), datë 5.11.2013, mes personit tjetër të lidhur S. K. dhe shoqërisë “(***)” sh.p.k. përbën akt civil volitiv – shprehje të vullnetit të lirë të palëve në një veprim juridik që përmbush konditat e parashikuara në nenin 663, të Kodit Civil. Efektet e prodhuara prej këtyre akteve mbeten të pacenuara, sidomos në rrethanat që të tretët e interesuar, të cilët janë edhe në marrëdhënie të posaçme farefisnore me njëri-tjetrin, nuk kanë ngritur ndaj personit tjetër të lidhur pretendime me natyrë pasurore, duke pranuar në mënyrë të heshtur situatën juridike konkrete.

Për sa më sipër:

➔ **Në përfundim, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar, si dhe të deklarimeve të subjektit gjatë hetimit administrativ, nuk rezultuan prova apo *indicie* që t’i krijonin Komisionit bindjen se subjekti i rivlerësimit mund të kishte përfituar ndonjë trajtim preferencial apo mund të kishte ushtruar ndikim, duke shfrytëzuar pozitën e tij si magjistrat, për përfitime të padrejta, në kuadër të kontratave sa më sipër referuar (kontrata e shitjes së pjesës ideale të truallit dhe kontrata e shkëmbimit), të nënshkruara nga babai i tij.**

III. Nga dokumentacioni i OSHEE-së konstatohet se personi tjetër i lidhur, babai i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e palës porositëse, ka nënshkruar me shoqërinë “(***)” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit, aktmarrëveshjen e datës 13.7.2012, me objekt apartamentin nr. (***), me sip. 53 m², në vilën e përbashkët nr. (***), kati i parë mbi katin përdhe, si dhe vendparkimi nr. 56, në oborrin e kësaj vile, kundrejt çmimit 40.000 euro, ndodhur në Kompleksin Turistik me vila individuale dhe të përbashkëta në parcelën nr. 6/1, G., Kavajë.

Komisioni i kërkoi shoqërisë “(***)” sh.p.k.:

- aktmarrëveshjen e sipërmarrjes për apartamentin dhe vendparkimin;
- kontratën e shitblerjes së apartamentit dhe të vendparkimit;
- dokumentin mbi dorëzimin e apartamentit dhe të vendparkimit, si dhe gjendjen e tyre në këtë moment;
- mënyrën e arkëtimit të çmimit nga porositësi dhe dokumentin fiskal të pasqyrimit të këtij transaksioni nga pala sipërmarrëse/shitëse.

Shoqëria “(***)” sh.p.k., informoi Komisionin se ka nënshkruar me shtetasin S. K. aktmarrëveshjen e datës 13.7.2012, lidhur me apartamentin nr. (***) dhe një post parkimi në objektin nr. (***), brenda kompleksit të ndërtuar nga kjo shoqëri në parcelën nr. 6/1 në G., Kavajë. Në aktmarrëveshje palët kanë përcaktuar çmimin e apartamentit dhe vendparkimin në vlerën 40.000 euro, nga të cilat, shtetasi S. K. ka likuiduar këstin e parë në vlerën 20.000 euro, sipas mandatarkëtimit nr. (***), datë 6.7.2012 (pra pagesë *cash*). Shoqëria “(***)” sh.p.k., deklaroi se nuk ka formalitete të tjera mes palëve.

Në lidhje me mundësinë e krijimit të kësaj pasurie, Komisioni hetoi mbi burimet financiare të prindërve të subjektit të rivlerësimit, duke shtuar në të ardhurat e realizuara nga shitja e apartamentit në Rr. “(***)”, Tiranë, shumën 3.780.000 lekë (trajtuar si transaksion në kuadër

të pasurisë nr. (***) – automjet tip “Mercedes Benz”), të ardhurat e realizuara nga burime të tjera (p.sh. pensioni)⁴⁶, si dhe likuiditetet në llogari bankare.

Pas verifikimit, Komisioni krijoi bindjen se prindërit e subjektit të rivlerësimit nuk kanë përdorur si burim për pagesën e shumës prej 20.000 euro sipas mandatarkëtimit nr. (***) , datë 6.7.2012, të ardhurat nga shitja e apartamentit, apo të ardhurat nga burimet e konfirmuara.

Për sa më sipër, Komisioni krijoi dyshimin se babai i subjektit të rivlerësimit nuk ka burime të ligjshme për të realizuar pagesën *cash* në shumën 20.000 euro. Këtë konstatim, Komisioni ia komunikoi si gjetje në rezultatin e hetimit edhe subjektit të rivlerësimit.

Në lidhje me sa më sipër, subjekti i rivlerësimit parashtroi me shkresë se: “... në komunikim me babain S. K. mbi këtë fakt, ai më deklaroi dhe më dorëzoi një kopje të aktmarrëveshjes datë 20.9.2011, që ai ka nënshkruar me shtetasin A. S., ndërtues me shoqërinë ‘(***)’ sh.p.k., te cilin e ka edhe krushqi të afërt (ai ka bashkëshorte shtetasen N. S., vajza e tezes së babait). Sipas kësaj marrëveshjeje, rezulton se: ‘S. K. ka marrë 30.000 euro kundrejt ndërtimit të objektit në Rr. ‘(***)’, Tiranë, nga kjo firmë, dhe se shuma do të llogaritet dhe likuidohet nga sipërfaqja e ndërtimit që do t’i takojnë pronarit S. K. ...’ . Dokumentin aktmarrëveshje si më sipër po ju a dorëzoi dhe kërkoj të merret si provë në këtë proces.

....

Pavarësisht dokumentacionit të mësipërm, kërkoj të thirret si dëshmitar shtetasi: A. S. ”.

Komisioni riçeli mbi këtë kërkesë, hetimin dhe ftoi për të dëshmuar shtetasin A. S., përfaqësues ligjor i shoqërisë “(***)” sh.p.k., i cili dha deklarinimin e tij përpara Komisionit. Deklarimet e këtij të fundit përputhen me shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit⁴⁷.

Për sa më sipër:

➔ Në përfundim, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar, si dhe të deklaramëve të subjektit gjatë hetimit administrativ, konfirmohet burimi i shumës 20.000 euro, paguar për apartamentin në G., Kavajë, te shoqëria “(***)” sh.p.k., si dhe nuk rezultuan prova apo *indicie* që t’i krijojnë Komisionit bindjen se subjekti i rivlerësimit mund të kishte përfutuar ndonjë trajtim preferencial apo mund të kishte ushtruar ndikim, duke shfrytëzuar pozitën e tij si magjistrat, për përfitime të padrejta, në kuadër të kontratës sa më sipër referuar (aktmarrëveshjen e datës 13.7.2012), të nënshkruara nga babai i tij.

Konkluzionet përfundimtare për kriterin e pasurisë

Komisioni, në përfundim të këtij hetimi administrativ, çmon se në vendimmarrjen e tij përfundimtare për subjektin e rivlerësimit duhet të marrë në konsideratë si më poshtë vijon:

Siç konstatohet dhe më lart nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka konstatuar se:

- Subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në DPV-të e viteve 2011 - 2015 dhe në deklaratën “Vetting”, duke mos deklaruar të ardhurat nga dhënia me qira e pasurisë dyqan në emër të personit të lidhur për këtë periudhë kohore, duke deklaruar për këtë marrëdhënie qiraje vetëm në vitin 2010.
- ✓ Subjekti nuk disponon të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për të blerë në qershor të vitit 2010 pasurinë automjet tip “Mercedes Benz 280 E”, prodhim i vitit 2006, me targa (***) , si dhe të përballojë shpenzimet e tjera, duke rezultuar me mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën 205.617 lekë.

⁴⁶ Shihni kërkesën nr. (***) prot., datë 8.10.2018, drejtuar ISSH-së dhe kthim-përgjigje të ISSH-së me shkresën nr. (***) prot., datë 12.10.2018.

⁴⁷ Shihni shkresën nr. (***) prot., datë 22.7.2019, ftesë për të dëshmuar, z. A. S.; procesverbal nr. (***) prot., datë 25.7.2019, deklaratë datë 25.7.2019, e dëshmitarit A. S. .

- ✓ **Subjekti, gjithashtu ka një mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shtesën në kursime dhe për të mbuluar shpenzimet në vitin 2006 në shumën 350.862 lekë.**
- ✓ **Subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklarin e gjendjes *cash* në vitet 2014, 2015, 2016, duke deklaruar në DPV gjendjen faktike të likuiditeteve në momentin e deklarin dhe jo gjendjen e tyre në 31 dhjetor të vitit përkatës të deklarin.**

Për sa më sipër janë konstatimet, të cilat Komisioni çmon t'i vlerësojë në vendimmarrjen e tij në respektim të ligjit, të qëllimit të ligjit dhe respektimit të parimit të proporcionalitetit, si një nga parimet më të rëndësishme në dhënien e një mase disiplinore.

Lidhur me faktin se a kemi pasaktësi nga subjekti në deklarinet periodike të sipërcituara dhe cila është pasoja që ka ardhur në drejtim të realizimit të procesi të rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, trupi gjykues çmon se për subjektin e rivlerësimit padyshim qëndron detyrimi që të deklarojë në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 9049/2003. Për këtë çështje Kolegji i Posaçëm i Apelit ka mbajtur qëndrimin e tij.

Kolegji i Posaçëm i Apelit, lidhur me këtë, në vendimin nr. 20/2019, në pikat 55 dhe 56 të tij, përcaktohet se: *[...] ligji nr. 9049/2003 dhe formulari i deklarin të pasurisë përcaktojnë detyrimin e subjektit deklarues të deklarojë në formën e përcaktuar prej tyre dhe jo të zgjedhin ata mënyra të personalizuar për të kryer këtë detyrim ligjor. Forma e deklarin nuk është trajtuar prej ligjit si një detyrim alternativ, i cili mbetet në vullnetin e subjektit, por një detyrim i mirëpërcaktuar, i cili duhet respektuar. ... Në këndvështrim të kuadrit ligjor, subjekti ka detyrë të deklarojë duke prezantuar një fotografi të interesave të tij pasurore e të drejtave mbi pasuritë e paluajtshme e të luajtshme në fund të çdo viti kalendarik, kurse institucionet verifikuese dhe kontrolluese të këtyre deklarimeve do të duhet më pas të ndjekin konceptet e logjikës dhe matematikës, përfshi rregullat kontabël për të konkluduar nëse këto deklarime prodhojnë ndonjë situatë të shkeljes së ligjit prej subjektit deklarues [...].*

Në këtë analizë Komisioni çmon se referuar vendimmarrjes së deritanishme apo dhe të qëndrimeve të konsoliduara, të mbajtura nga Kolegji i Posaçëm i Apelit⁴⁸, pasaktësitë në deklarime nuk mund të konsiderohen si shkelje të asaj mase, të cilat mund të shërbejnë si bazë ligjore për marrjen e masës së shkarkimit.

Në vendimin nr. 5/2019 përcaktohet se” *[...] Në vijim të analizës dhe interpretimit të dispozitave ligjore si më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, faqja 13 nga 37, vlerëson se sipas ligjit nr. 84/2016, pamjaftueshmëria e deklarin për deklarinet e mëparshme periodike të pasurisë, nëse subjekti ka bërë deklarin të pasaktë, ka fshehur pasurinë apo ka bërë deklarin të rremë, në vitet përkatëse, nuk është element i mjaftueshëm për t'u konsideruar si një shkak i vetëm dhe i veçuar, që prodhon situatën e deklarin të pamjaftueshëm, në kuptim të neneve 33, pika 5 dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 për shkarkimin e subjektit, por ai mbetet një element, i cili konsiderohet në vlerësimin e përgjithshëm të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit... ”*

Në vendimin nr. 19/2019, në pikën 22.14 dhe 22.15 të tij përcaktohet se: *[...] trupi gjykues vëren se objekt i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, janë edhe deklaratat e pasurisë të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja që, mbështetur në ligjin nr. 84/2016, nëse subjekti ka bërë deklarin të pasaktë, ka fshehur pasurinë apo ka bërë deklarin të rremë, në vitet përkatëse, nuk është element i mjaftueshëm për t'u konsideruar si një shkak i vetëm dhe i veçuar, që prodhon situatën e deklarin të pamjaftueshëm, në kuptim të neneve 33, pika 5 dhe 61, pika 3, e ligjit nr. 84/2016, për shkarkimin e faqe 11 nga 18 subjektit, por ai mbetet një element, i cili konsiderohet në vlerësimin e përgjithshëm të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit. Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, përcakton që deklarinet e interesave private dhe pasurore, të paraqitura më*

⁴⁸ Vendimet nr. 11/2018 (JR), datë 22.11.2018; nr. 5/2019 (JR), datë 18.2.2019; nr. 11/2018 (JR), datë 22.11.2018; dhe nr. 5/2019 (JR), datë 18.02.2019 të Kolegjit.

parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji. Këto deklarata, së bashku me provat e tjera, vlerësohen në tërësi me rrethanat e çështjes, për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë. Kontrolli i deklaratës “Vetting” dhe krahasimi i saj me deklaratimet e mëparshme, vlerësohet si mjet që shërben gjatë procesit të rivlerësimit për kriterin pasuror, për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklaratimeve të subjektit, në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi ligjshmërinë e pasurisë së subjektit apo mjaftueshmërinë e deklaratimeve të tij. Kjo merr vlerë specifike, sidomos në rastin e vlerësimit të ligjshmërisë së burimeve të krijimit të një pasurie, pasi këtu paraqitet deklarimi i subjektit në momentin e krijimit të pasurisë, si dhe transaksionet e kryera në vite me këtë pasuri. Kjo analizë është në përputhje edhe me vendimin nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese, në të cilin nënvizohet se organet e reja kushtetuese të procesit të rivlerësimit nuk kanë zhbërë sistemin ekzistues të kontrollit dhe vlerësimit të funksionarëve publikë. Po në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese mban qëndrimin se kompetencat e organeve ekzistuese, siç janë ILDKPKI-ja, DSIK-ja apo organet e vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, nuk mund të shihen të shkëputura nga kompetencat e organeve të rivlerësimit, pasi procesi i rivlerësimit është një proces kompleks, i cili në bazë të tij ka parimin e bashkëpunimit, të ndërveprimit dhe të kontrollit mes të gjitha organeve të përfshira në të [...]”

Në bazë të pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 5, të nenit 33, dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, në analizë të konstatimeve si më sipër, gjatë vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni vlerësoi se pasaktësitë në deklaratime dhe konstatimet si më sipër lidhur me balancat negative në shuma të vogla, nuk janë bërë me qëllim fshehjen e pasurisë apo me qëllim deklarimin në mënyrë të pasaktë të të dhënave për shkak të mungesës së burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive. Për këtë shkak, në proporcion me të gjitha rrethanat që kanë lidhje me rivlerësimin e pasurisë si dhe qëndrimin reflektues që mbajti subjekti i rivlerësimit në lidhje me çdo pasaktësi, ato nuk janë konsideruar si shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit të subjektit nga detyra.

Në rastin konkret, nga hetimi dhe nga analiza e provave të administruara, nuk rezultoi që pasaktësitë në deklaratimet periodike vjetore të kenë pasur për qëllim fshehjen e ndonjë pasurie apo tregimin jo saktë të të dhënave me qëllim për të justifikuar ligjshmërinë e burimeve dhe të krijimit të pasurive.

Për këtë arsye, Komisioni çmon se nuk jemi në kushtet e zbatimit të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Në analizë të gjetjeve, trupi gjykues çmon gjithashtu se nuk jemi as para zbatimit të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pra, të cenimit të besimit të publikut nga subjekti i rivlerësimit.

Cënimi i besimit të publikut nga ana e magjistratit është i lidhur ngushtë me faktin se ky i fundit duhet të bëjë një shkelje ligjore gjatë ushtrimit të funksionit ose jashtë tij. Në rastin konkret është shumë e rëndësishme të arsyetohet se cila do të ishte masa e kësaj shkeljeje dhe se sa një shkelje e caktuar mund të çënojë besimin e publikut për të legjitimuar marrjen e një vendimi në respektim të parimit të proporcionalitetit.

Komisioni çmon se marrja e një mase disiplinore në përputhje me parimin e proporcionalitetit është në përputhje me qëllimin e ligjit për rivlerësimin. Kolegji ka një jurisprudencë të konsoliduar lidhur me faktin se si duhet të jetë sjellja e një gjyqtari gjatë ushtrimit dhe jashtë ushtrimit të detyrës, në zbatimin e legjislacionit në fuqi.

Në pikat 41 dhe 22.15 të vendimit nr. 28/2019, përcaktohet se: [...] *trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se kjo mënyrë sjelljeje e subjektit të rivlerësimit tregon qasjen e tij në raport me respektimin e ligjit, zbatimin e të cilit është detyra parësore e një gjyqtari, nëpërmjet vendimeve të dhëna, por jo vetëm. Sjellja jashtëgjyqësore e gjyqtarit, për shkak të rëndësisë që ka besimi i publikut tek integriteti dhe autoriteti i pushtetit gjyqësor, është objekt rregullimi i normave të etikës gjyqësore në Shqipëri dhe pjesë e standardeve ndërkombëtare që udhëzojnë shembujt*

më të mirë të sjelljes dhe integritetit. Më konkretisht, Kodi i Etikës së Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, në rregullin 15 përcakton: 'Gjyqtari duhet të kryejë të gjitha veprimtaritë jashtëgjyqësore në mënyrë të tillë që ato të mos hedhin dyshime të arsyeshme për paanësinë e tij, të ulin autoritetin e pushtetit gjyqësor ose të ndërhyjnë në kryerjen e detyrave gjyqësore'. 43. Në komentarin e Parimeve të Bangalores për Sjelljen Gjyqësore, është trajtuar gjerësisht sjellja e gjyqtarëve në veprimtarinë jashtëgjyqësore duke e lidhur me elemente të dinjitetit, integritetit, paanësisë dhe reputacionit, ndër të tjera. Për sa i përket sjelljes së gjyqtarëve, në komentari shtjellohet, ndër të tjera: Paragrafi 108 – Kërkohet respektimi i rreptë i ligjit – Shkelja e ligjit nga një gjyqtar mund të dëmtojë reputacionin e funksionit si gjyqtar, të inkurajojë mosrespektimin e ligjit dhe të cenojë besimin e publikut në integritetin e vetë gjyqësorit [...]. Një gjyqtar është i detyruar të mbështesë ligjin. Ai ose ajo nuk duhet të vendoset në një pozicion konflikti në zbatim të ligjit. Çfarë të tjerët mund të shihet si një shkelje relativisht e vogël, te gjyqtari mund të tërheqë publicitetin dhe dëmtojë imazhin e gjyqtarit dhe të shtrojë pikëpyetje në lidhje me integritetin e tij/saj dhe integritetin e gjyqësorit.

Paragrafi 109 – Sjellja personale e një gjykatësi ndikon në të gjithë sistemin gjyqësor – Besimi në gjyqësor bazohet jo vetëm në kompetencën dhe zellin e anëtarëve të tij, por edhe mbi integritetin dhe drejtësinë e tyre morale. Gjykatësi jo vetëm që duhet të jetë një 'gjyqtar i mirë', por edhe një 'person i mirë', edhe nëse pikëpamjet për çfarë nënkupton ky koncept mund të ndryshojnë në qarqe të ndryshme të shoqërisë. Nga këndvështrimi i publikut, një gjykatës jo vetëm që është zotuar t'u shërbejë idealeve të drejtësisë dhe të vërtetës mbi të cilat është ndërtuar shteti ligjor dhe themelet e demokracisë, por edhe t'i mishërojë ato. Në përputhje me rrethanat, cilësitë personale, sjellja dhe imazhi që projekton gjyqtari ndikojnë në sistemin gjyqësor në tërësi dhe, rrjedhimisht, edhe vetëbesimin që publiku vendos në të. Kërkesat e publikut ndaj gjyqtarëve janë shumë më të larta sesa kërkohet nga bashkëqytetarët, standarde të sjelljes që janë shumë më të larta se ato të kërkuara të shoqërisë në tërësi. Në fakt, publiku pret një sjellje pothuajse të paqortueshme nga një gjykatës. Është sikur funksioni gjyqësor, që është gjykimi i të tjerëve, ka imponuar një kërkesë që gjyqtari të mbetet përtej gjykimit të arsyeshëm të të tjerëve në çështje që mund të cenojnë në çfarëdolloj mënyre rolin gjyqësor dhe gjykatën [...]

[...] Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues vëren se sjellja e subjektit të rivlerësimit bie ndesh me mënyrën e sjelljes që pritet nga një gjyqtar, i cili edhe jashtë orarit të punës duhet të kujdeset që sjellja e tij të jetë në të mirë të funksionit zyrtar që ushtron, të mos karakterizohet nga fiktiviteti dhe mashtrimi i çdo lloji. Ky përfundim i trupit gjykues gjen mbështetje edhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Konkretisht, në çështjen e regjistruar në Kolegj me nr. 31/2018 (JR), trupi gjykues, në vlerësimin e tij [në paragrafët nr. 29 dhe 34] për fiktivitetin lidhur me çmimin e vendosur nga palët në funksion të përfitimit të një kredie, dhe lidhur me përfitimin e një prone [në paragrafin nr. 50] në kushtet kur nuk përmbusheshin kriteret e vendosura nga një akt nënligjor (VKM), ka konstatuar shkaqe në të cilat gjen zbatim neni 61, pika 5, pasi subjekti ka cenuar besimin e publikut te drejtësia për shkak të kontratave fiktive për të përfituar kredi bankare, dhe për shkak të përfitimit të një pasurie në kushtet kur subjekti nuk përmbushte kriteret ligjore për përfitim [...].

Në rastin konkret pasaktësitë e konstatuara në DPV, si dhe ekzistenca e një balance të vogël në analizën financiare të subjektit gjatë periudhës së rivlerësimit, përbëjnë arsye të cilat nuk mund të konsiderohen si mënyrë sjelljeje e subjektit në kundërshtim me ligjin, që ka pasur si qëllim përfitimin e një të drejtë në kundërshtim me aktet nënligjore në fuqi.

E njëjta logjikë vlen dhe duhet të përdoret në konkluzionin se diferencat në vlerë negative të vogël pas analizës financiare të subjektit nuk cenojnë aspak burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive të deklaruara nga ana e subjektit të rivlerësimit.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se:

i. Subjekti ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

- ii. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Subjekti nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në posedim ose në përdorim të tij.
- iii. Pasaktësia e konstatuar në deklarin më sipër, si dhe masa e konstatuar në mungesën e burimeve të ligjshme, nuk është në atë shkallë sa të përbëjë shkak për shkarkim, sipas pikës 3, të nenit 61 dhe nuk ndikon në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit, duke cenuar besimin e publikut te drejtësia.
- iv. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Artur Kalaja, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të gërmës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

B. VLERËSIMI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, me shkresën nr. (***) prot., datë 21.1.2018, ka dërguar raportin nr. (***) prot., datë 30.10.2017, të deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. (***) datë 20.1.2018, të KDZH-së për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016 (bazuar në kërkesën e Komisionit, me shkresën nr. (***) datë 30.10.2017). Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarin për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Si konkluzion, Grupi i Punës i DSIK-së ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Artur Kalaja.

Gjatë hetimit administrativ nuk ka pasur të dhëna nga cilido burim i ligjshëm në lidhje me kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo veprimtari korruptive të tij.

Për sa më sipër, Komisioni konstatoi përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit, z. Artur Kalaja, për vazhdimin e detyrës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka hartuar aktin nr. (***) prot., datë 8.4.2019, “Raport për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Artur Kalaja, në të cilin subjekti është vlerësuar pozitivisht për aftësitë profesionale, të cilin e ka dërguar në Komision si pjesë e dosjes nr. (***) prot., datë 24.1.2017.

Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale është bazuar në:

- 1) formularin e vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 2) pesë dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 3) të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nga Komisioni u bazua në gjetjet e këtij raporti, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kreun II, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në gjetjet e Komisionit gjatë hetimit administrativ.

a) Saktësia e formularit të vetëdeklarimit

Formulari paraqitet i plotë dhe i nënshkruar, pa mangësi dhe kundërthënie, sipas shtojcës që parashikon ligji.

b) Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit

Duke iu referuar të dhënave të deklaruara në formular, konstatohet se nga data 1.1.2007 dhe deri aktualisht, subjekti i rivlerësimit ka kryer funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë.

c) Detyrat e kryera 3 vitet e fundit dhe të dhënat statistikore

Subjekti i rivlerësimit, z. Artur Kalaja, ka deklaruar se 3 vitet e fundit ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe çdo proces që lidhet me këtë veprimtari deri në dhënien e vendimit, duke përcaktuar fushën e të drejtës civile, pranë Kolegjit Civil të Gjykatës së Apelit Tiranë. Gjyqtari Artur Kalaja nuk ka deklaruar specializime në ndonjë fushë të së drejtës.

Lidhur me të dhënat statistikore (për ngarkesën dhe çështjet e përfunduara), sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, z. Artur Kalaja, për numrin e çështjeve të ngarkuara sipas viteve, paraqiten të dhënat si në poshtë vijon:

- për vitin 2014, i janë caktuar 332 çështje;
- për vitin 2015, i janë caktuar 390 çështje;
- për vitin 2016, i janë caktuar 412 çështje.

Sipas këtij deklarimi rezultojnë **1134** çështje të caktuara gjithsej për 3 vjet.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar numrin e çështjeve të përfunduara si relator, sipas viteve:

- për vitin 2014, ka përfunduar 372 çështje (nga të cilat 322 në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe 50 çështje të gjykuara prej tij, si i deleguar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë);
- për vitin 2015, ka përfunduar 344 çështje;
- për vitin 2016, ka përfunduar 356 çështje.

Sipas këtij deklarimi rezultojnë **1.072** çështje të përfunduara gjithsej për tre vjet (në formular ka një gabim aritmetik, pasi është shkruar 1.076 çështje të përfunduara).

Lidhur me çështjet e mbartura vitin e fundit të ushtrimit të detyrës, gjyqtari Artur Kalaja ka deklaruar 6 çështje për gjykim, të mbartura nga viti 2016 dhe dy çështje të pezulluara nga viti 2016. Pra, gjithsej janë 8 çështje të mbartura.

ç) Trajnimet në 3 vitet e fundit

Për sa u përket trajnimeve të kryera në Shkollën e Magjistraturës, subjekti i rivlerësimit, z. Artur Kalaja, ka deklaruar në formular se ka ndjekur 7 trajnime në Shkollën e Magjistraturës, në tre vitet e fundit. Këto trajnime i përkasin temave si më poshtë:

1. “Etika gjyqësore”, datë 17.4.2014.
2. “Dëmi jashtë kontraktor dhe përgjegjësitë që rrjedhin”, datë 2.2.2015.
3. “Dëmet. Shpërblimet dhe kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit (ligji 10076/2009)”, datë 30.3.2015.

4. “Konventa e Hagës në fushën e të drejtës ndërkombëtare private”, datë 8.6.2015.
 5. “Zbatimi i standardeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, për nenin 10 të KEDNJ-së”, datë 21 - 22.7.2015.
 6. “Shkelje e pronësisë intelektuale”, datë 28.1.2016.
 7. “Nënshkrimi elektronik. Garancitë procedurale”, datë 7.4.2016.
- Pjesëmarrjen në këto trajnime gjyqtari e vërteton me vërtetimin nr. (***) , datë 21.10.2016, lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës.

Gjyqtari ka deklaruar edhe trajnimet e zhvilluara jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, të cilat janë realizuar përpara periudhës së rivlerësimit, me temat si më poshtë:

1. Trajnim në Kajro, Egjipt, nga data 24.7.2006, deri në datën 3.8.2006, organizuar nga Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë Drejtësisë, me temë “Arbitrazhi”.
2. Trajnim njëjavor në Strasburg, Francë, organizuar nga Këshilli i Europës, në përfundim të të cilit në datën 30.4.2008 ka marrë certifikatën si “Trajner Kombëtar për Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, nga Këshilli i Europës”.
3. Trajnim njëjavor në Strasburg, Francë, organizuar nga Këshilli i Europës dhe Bashkimi Europian, në përfundim të të cilit në datën 4.5.2011 është certifikuar si “Trajner mbi “Hetimet ndaj Pastrimit të Parave, Korrupsionit dhe Gjurmimit të Aseteve”, nga Qendra Ndërkombëtare e Rikuperimit të Aseteve e Institutit të Bazelit, mbi qeverisjen në kuadër të projektit kundër korrupsionit (PACA), të Këshillit të Europës dhe Bashkimit Europian.
4. Në periudhën 2010 – 2011 ka kryer dhe programin “Master i Nivelit të Dytë, në Shkencat Civile”.

Për pjesëmarrjen në këto trajnime, jashtë Shkollës së Magjistraturës, gjyqtari ka paraqitur tri dokumente që janë certifikatat përkatëse për çdo trajnim, si dhe certifikatën nga Universiteti i Tiranës, për përfundimin e studimit “Master i Nivelit të Dytë në Shkencat Civile”, gjatë periudhës 2010 – 2011.

Po kështu, për sa u përket trajnimeve të tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, subjekti i rivlerësimit, z. Artur Kalaja, ka deklaruar në formular pjesëmarrjen e tij në tri aktivitete të zhvilluara jashtë shtetit, përkatësisht në vitet 2006, 2008 dhe 2011.

Asnjë prej këtyre aktiviteteve nuk i përket periudhës së rivlerësimit “tre viteve të fundit”.

d) Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Gjatë periudhës së vlerësimit, subjekti i rivlerësimit, z. Artur Kalaja, ka përzgjedhur dhe ka paraqitur tri dokumente ligjore të llojit “vendim gjyqësor”, një prej të cilëve i përket vitit 2014, i dyti i përket vitit 2015 dhe i treti i përket vitit 2016.

dh) Pesë dosjet e shortuara

Në datën 24.1.2019, në Gjykatën e Apelit Tiranë u përzgjedhën me short pesë dosje:

- Dosja 1 – që i përket vendimit nr. 3231, datë 26.9.2014, u përcoll nga Gjykata e Lartë, me shkresën nr. (***) , datë 6.3.2019, protokolluar me nr. (***) , datë 6.3.2019.

- Dosja 2 – që i përket vendimit nr. (***) , datë 23.9.2016, u përcoll nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. (***) , datë 21.02.2019, protokolluar me nr. (***) datë 21.2.2019.

- Dosja 3 – që i përket vendimit nr. (***) , datë 23.1.2015, u përcoll nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. (***) , datë 21.2.2019, protokolluar me nr. (***) , datë 21.2.2019.

- Dosja 4 – që i përket vendimit nr. (***), datë 18.3.2015, u përcoll nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me shkresën nr. (***), datë 20.2.2019, protokolluar me nr. (***), datë 22.2.2019.

- Dosja 5 – që i përket vendimit nr. (***), datë 23.1.2015, u përcoll nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. (***), datë 21.2.2019, protokolluar me nr. (***), datë 21.2.2019.

- ❖ Në lidhje me të pesë dosjet e shortuara, vendimet gjyqësore paraqiten me strukturë të qartë, në kuptim të ndarjes standarde (hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës).
- ❖ Nga pikëpamja e strukturës, pjesa arsyetuese e secilit vendim është e ndarë vetëm në paragrafë, që paraqesin në mënyrë kronologjike vendimin e gjykatës, rrethanat dhe provat e çështjes.
- ❖ Fjalitë paraqiten të formuluar qartë dhe përmbajnë referenca në ligj dhe në provat përkatëse. Teksti paraqitet i qartë dhe i kuptueshëm dhe janë respektuar rregullat e drejtshkrimit.
- ❖ Kryesisht të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, përjashtim bën përdorimi i germës “ë”, e cila është shkruar “e”. Fjalitë paraqiten me gjatësi normale dhe të kuptueshme.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-SË

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se gjyqtari Artur Kalaja ka marrë titullin “jurist”, nga Universiteti i Tiranës në datën 5.7.1996, dhe titullin “magjistrat gjyqtar”, nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2001. Pas studimeve, në datën 2.10.2001 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Më pas, në datën 16.5.2006 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë, detyrë që e kryen edhe aktualisht.

Këto të dhëna nuk janë paraqitur nga subjekti në formularin e vetëvlerësimit, por janë paraqitur nga specialistja e burimeve njerëzore pranë KLGJ-së, sipas shkresës nr. (***), datë 25.1.2019.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016, për gjyqtarin Artur Kalaja janë paraqitur gjithsej 6 ankesa në Inspektoratin e KLD-së (1 në vitin 2013, 3 në vitin 2014, 1 në vitin 2015 dhe 1 në vitin 2016):

- 4 ankesa (1 e vitit 2013, 1 të vitit 2014, 1 e vitit 2015 dhe 1 e vitit 2016) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor;
- 2 ankesat e tjera janë verifikuar dhe rezultatet e tyre janë si vijon:
- 1 ankesë e vitit 2014, verifikuar për mosrespektim formal të ligjit, është arkivuar me arsyetimin se pretendimi është i pabazuar;
- 1 ankesë e vitit 2014, verifikuar mbi bazën e informacionit periodik, ardhur nga kryetari i gjykatës, lidhur me vendimet e cenuara, është vendosur t’i regjistrohet gjyqtarit, për efekt vlerësimi profesional dhe etik.

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Artur Kalaja, përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

ANALIZA E GJETJEVE

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Artur Kalaja, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit.

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, është konstatuar se gjyqtari identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, z. Artur Kalaja, ka aftësi në arsyetim ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij, janë të qarta dhe të kuptueshme. Në çdo rast respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe përdor rregullisht karakteret e gjuhës shqipe, me përjashtim të germës “ë”. Struktura e vendimeve të tij është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standardizuar. Ajo përmban elementët e kërkuar nga legjislacioni procedural, civil dhe penal. Subjekti i rivlerësimit mban të njëjtin stil në hartimin e akteve dhe organizimi strukturor i vendimeve paraqitet në nivel të kënaqshëm.

Përmbajtja e vendimit përfundimtar është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, e cila paraqitet e thjeshtë dhe e kuptueshme.

Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

Në dispozitiv, në një rast është treguar e drejta e rekursit për palët (shihni dosjen 2) dhe në një rast tjetër gjykata është shprehur për shpenzimet gjyqësore (shihni dokumentin 3).

Vendimet janë arsyetuar shpejt dhe janë dorëzuar në sekretari brenda afatit.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit, z. Artur Kalaja, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë, në dhomën civile.

Lidhur me ngarkesën e çështjeve, subjekti ka deklaruar se për periudhën 2014 – 2016, i janë caktuar për gjykim gjithsej 1134 çështje, ka përfunduar si relator 1072 çështje dhe nga viti 2016 ka mbartur 8 çështje. Këto të dhëna i përkasin viteve të plota kalendarike 2014, 2015 dhe 2016.

Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna, është 94,5 %.

Sipas të dhënave statistikore, të përcjella nga Gjykata e Apelit Tiranë për efekt të organizimit të shortit në këtë gjykatë, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, gjyqtari Artur Kalaja ka përfunduar 940 çështje, nga të cilat 257 çështje penale, 675 çështje civile të përgjithshme, 8 çështje civile familjare. Gjatë vitit 2014, gjyqtari Artur Kalaja ka gjykuar edhe 50 çështje, të deleguara në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë.

Përfundimisht, çështje të gjykuara për periudhën e rivlerësimit janë **990 çështje**.

Në Sistemin e Vlerësimit, Aneksi 1, pika 3, “Standardi sasior”, pikës 3, germa I, përcaktohet se gjyqtari i Gjykatës së Apelit i dhomës civile duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 200 gjykime çështjesh civile, brenda një viti kalendarik.

Ky rregull nënkupton një ngarkesë sasiore prej jo më pak se 600 gjykime çështjesh civile për periudhën prej tre vjetësh. Duke zbatuar këtë rregull në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Artur Kalaja, konstatohet se ngarkesa e tij sasiore ka qenë mbi standardin sasior.

Kohëzgjatja e gjykimeve. Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short për gjyqtarin Artur Kalaja, rezultoi se nga dita e marrjes së akteve me short deri në dhënien e vendimit ka qenë e ndryshme për çdo çështje. Kohëzgjatja më e shkurtër ka qenë 7 ditë (*shihni* dosjen 5), ndërsa kohëzgjatja më e lartë ka qenë 11 muaj e 5 ditë (*shihni* dosjen 3). Në rastet e tjera gjykimet kanë zgjatur 10 muaj e 26 ditë, 10 muaj dhe 19 ditë, 3 muaj dhe 3 ditë.

Në katër rastet e tjera konstatohet se është tejkaluar afati standard i përcaktuar për gjykimet në shkallë të dytë sipas atij vendimi, por ky tejkalim ka një shkak të arsyeshem, pasi seanca e parë gjyqësore është caktuar nga kryetari i gjykatës sipas nenit 460/2 të Kodit të Procedurës Civile, për çështjet civile dhe sipas nenit 426/1 të Kodit të Procedurës Penale, për çështjet penale. Prandaj nuk ka tejkalim të afatit nga ana e gjyqtarit.

Si datë e arsytimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e dhëna e vetme objektive për këtë fakt. Lidhur me kohën mesatare të arsytimit të vendimeve gjyqësore, nga vëzhgimi i pesë dosjeve të shortuara, rezultoi se gjyqtari Artur Kalaja i kushton rëndësi të veçantë arsytimit në kohë të shpejtë të vendimeve.

Vendimet e dhëna nga subjekti në cilësinë e relatorit, në të pesë rastet e shqyrtuara, janë pranuar nga palët, pa paraqitur rekurs, gjë që dëshmon për aftësinë e gjykatës për të bindur palët në drejtësinë e vendimit të dhënë.

b) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, përgjithësisht nuk janë konstatuar mangësi në aftësitë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të.

Është konstatuar se aktet e hartuara nga gjykata janë të rregullta, të sakta dhe të plota. Procesverbali gjyqësor dokumenton gjykatën, trupin gjykues, palët, objektin, kohën dhe vendin, si dhe veprimet që kryhen në seancë, konform kërkesave të Kodit të Procedurës Civile dhe Kodit të Procedurës Penale.

Vendimet e ndërmjetme fiksohen në procesverbalin e seancës gjyqësore.

Gjithashtu, në pesë dosjet janë konstatuar edhe disa mangësi, që janë të njëjta, që tregon se bëhet fjalë edhe për metodologji pune. Relatimi i gjyqtarit për çështjen konkrete bëhet në mënyrë verbale dhe përmbledhet me një frazë të përgjithshme në procesverbalin gjyqësor. Nuk dokumentohet shkaku i fillimit me vonesës së seancës gjyqësore.

Dosjet janë të inventarizuara rregullisht.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Gjyqtari Artur Kalaja është diplomuar “jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 5.7.1996 dhe titullin “magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2001.

Pas studimeve, në datën 2.10.2001, është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Më pas, në datën 16.5.2006, është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit Artur Kalaja.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Artur Kalaja dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, z. Artur Kalaja.

Për vetë gjyqtarin Artur Kalaja në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve.

Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhen me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave.

Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, z. Artur Kalaja, nuk ka respektuar rregullat procedurale.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara në procesverbalin gjyqësor në format letër, është konstatuar se komunikimi ka qenë i qartë dhe i rregullt. Gjuha e përdorur në seancë gjyqësore dhe në akte tek tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Nga tri dokumentet ligjore dhe pesë dosjet e vëzhguara, bashkëpunimi me administratën dhe anëtarët e trupit gjykues çmohet të ketë qenë në nivelin e duhur, pasi është konstatuar se arsyetimi i vendimit dhe dorëzimi i dosjes gjyqësore në sekretari është bërë në çdo rast pa vonesa, çka dëshmon aftësi të bashkëpunimit me anëtarët e trupit gjykues dhe administratën gjyqësore.

c) Gatishmëria për t’u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, z. Artur Kalaja, i ka kushtuar rëndësi formimit akademik. Pas disa viteve nga diplomimi “jurist” në vitin 1998 dhe titullit “magjistrat gjyqtar” në vitin 2001, ka marrë pjesë dhe në studimet “Master i Nivelit të Dytë në Shkencat Civile”, gjatë periudhës 2010 – 2011, në Universitetin e Tiranës. Në periudhën e rivlerësimit ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 7 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Ai ka marrë pjesë dhe

në aktivitete të tjera, jashtë shkollës së magistraturës, por këto i janë zhvilluar para periudhës së rivlerësimit kalimtar.

VLERËSIMI I ANKESAVE DHE I DENONCIMEVE

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit bazuar në ankesat e subjekteve në KLD

Sikurse është shprehur më sipër, sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016, për gjyqtarin Artur Kalaja janë paraqitur gjithsej gjashtë ankesa në Inspektoratin e KLD-së.

KLD-ja ka marrë në shqyrtim të gjitha ankesat e listuara në raportin e saj dhe ka arritur në përfundimin se faktet dhe shkaqet për të cilat janë bërë këto ankesa lidhen me mënyrën e përfundimit të themelit të çështjes gjyqësore dhe nuk ka *indicie* për të provuar pretendimin e tyre, për gjetje thelbësore që do të ndikonin në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Për sa më sipër, nuk ka indicie për të provuar pretendimin e tij për gjetje thelbësore që do të ndikonin në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit bazuar në denoncimet e administruara nga Komisioni. Ndaj subjektit të rivlerësimit janë bërë këto denoncime:

1. denoncim nr. (***) prot., datë 8.1.2018, i shtetasit A. M. T.;
2. denoncim nr. (***) prot., datë 15.2.2018, i shtetasit E. Gj. Sh. etj.;
3. denoncim nr(***)prot., datë 13.3.2018, i shtetasit B. H. B.;
4. denoncim nr(***)prot., datën 7.12.2018, i shtetasit Sh. R. B.;
5. denoncim nr. (***) prot., datë 11.2.2019, i shtetasit Z. B. H.;
6. denoncim nr. (***) prot., datë 22.5.2019, i shtetasit R. H. R. .

Në të shumtën e rasteve, faktet dhe shkaqet për të cilat bëhen ankesat, lidhen me bazueshmërinë në ligj dhe në prova të vendimit gjyqësor, të cilat kontrollohen nga gjykata në nivel më të lartë sipas procedurës, të cilat nuk janë objekt shqyrtimi nga Komisioni në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, Komisioni analizoi dhe vlerësoi aftësitë profesionale bazuar në kriteret e përcaktuara në nenet 71/a dhe 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në çdo rast, vlerësimi është bërë në drejtim të njohurive ligjore dhe arsytimit ligjor, pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, në analizë të të gjitha denoncimeve, Komisioni konstatoi se nuk ka indicie për të provuar pretendimet e denoncuar, për gjetje që do të ndikonin në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Nga vlerësimi tërësor i aftësive profesionale, u kontaktua se mangësitë e evidentuara nuk janë të tilla që të cenojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit apo që të kenë cenuar të drejtat e palëve në proces, në kuptim të pikave 3 dhe 5, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, dhe, si rrjedhim, Komisioni çmoi që subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, duke respektuar të drejtat e palëve ose viktimave, ka qenë eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe për këtë arsye është vlerësuar “i aftë” profesionalisht.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Artur Kalaja, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Artur Kalaja, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.
 2. Ky vendim i arsyetuar u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
 3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
 4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- U shpall në Tiranë, në datën 8.11.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela Qirko
Kryesuese

Alma Faskaj
Relatore

Firdes Shuli
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta